

MAHIR DOMI

ALFABETI I GJUHËS SHQIPE DHE KONGRESI I MANASTIRIT (14-22 nëndor, 1908)*

Kongresi i Manastirit, 60-vjetori i të cilit u përkujtua gjerësisht sivjet në vendin tonë, ka zënë një vend të nderuar në historinë e popullit shqiptar, si ngjarje që shpreh një moment të rëndësishëm, një aspekt të shënuar të luftës së tij shekullore për kulturë kombëtare, për pavarësi e përparim, si një ndër aksionet e Rilindjes sonë, në fazën e saj të fundit, me rëndësi të veçantë për kuptimin që pati e gjurmët që la.

Shprehje e ndjenjave të zjarra patriotike dhe e aspiratave për dije e jetë të përparuar të popullit tonë në një fazë vendimtare të luftës së tij çlirimtare kundër një pushtuesi të huaj ndër më të egrit e prapanikët, Kongresi i Manastirit, me gjithë kufizimet e dobësitë e tij, që rrjedhin kryesisht nga kushtet historike të kohës, hyn në radhën e atyre ngjarjeve që kanë shënuar ecjen përpara të kombit tonë.

Partia jonë e Punës, trashëgimtare e denjë e traditave më të ndritura patriotike, revolucionare dhe përparimtare të popullit tonë, dhe shoku Enver i kanë vlerësuar lart këto tradita. Ata porositin t'i çmojmë ato duke ju dhënë një vlerësim të drejtë marksist-leninist, të marrim ç'kanë më pozitive e, duke e vënë në shërbim të së tanishmes, ta bëjmë një mjet të edukimit patriotiko-revolucionar. Kongresin e Manastirit e ngjarje të shënuara të tjera si ai, Partia i ka parë si etapa të luftës për liri e dituri të popullit tonë, që duhet t'i përkujtojmë me nderim. Shoku Enver, duke folur për veprimtarinë e gjallë e të guximshme që zhvilluan rilindasit tanë në lëmin arësimor-kulturor krahas luftës me armë, thotë: «Në kushtet e terrorit otoman nuk ishte lehtë të bëje atë që bënë ata, të shkruaje, të shtypje e të dërgoje në Shqipëri mijëra abetare e libra të tjera, të hapje shkollën e parë shqipe më 1887, të organizoje një kongres të tërë si ai i Manastirit për caktimin e alfabetit unik të shqipes dhe të tëra këto patën pa dyshim reperkusione të mëdha, të cilat gjetën pasqyrimin e tyre të mirë në rritjen e vrullshme të lëvizjes revolucionare dhe të kryengritjes së armatosur» (Nga fjala në pritjen e dhënë me rastin e 50-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, më 28.XI.1962).

Kongresi i Manastirit hyri në histori si «Kongresi i Abesë», Kongresi i alfabetit. Ai mori vendime të rëndësishme në punë të shkrimit të gjuhës sonë: i dha fund kaosit që zotëronte aty, i hapi rrugën njëzimt të plotë të alfabetit, prej tij u përpunua alfabeti që përdorim ne sot. Duke zgjidhur këtë problem që s'ishte në atë kohë një problem i thjeshtë gjuhësor

* Variant i zgjeruar i referatit të mbajtur në sesionin shkencor kushtuar 60-vjetorit të Kongresit të Manastirit.

apo letrar-kulturor, por një problem i mprehtë politik, ai i dha një ndihmë të mirë lëvizjes sonë kombëtare. Me rëndësi qe edhe kontributi i tij i drejtpërdrejtë në luftën politike çlirimtare të popullit tonë. Ai vendosi kontakte midis shqiptarëve të rretheve e krahinave të ndryshme, forcoi lidhjet midis tyre, dha rast për takime, për bisedime e mbledhje të veçanta midis patriotëve, të cilat shërbyen për kristalizimin e kërkesave të lëvizjes sonë kombëtare në situatën e asaj kohe, për bashkërendimin e veprimeve drejt objektsh të përbashkëta. Të gjitha këto ndihmuan për t'i dhënë një vull të ri lëvizjes çlirimtare. Përfundimet pozitive me të cilat u mbyllën punimet e këtij kongresi dhanë zemër për të ndjekur edhe më tutje praktikën e organizimit herë pas here të mbledhjeve të përgjithshme të tilla, për të shprehur botërisht me anë të tyre vullnetin e popullit tonë dhe për të marrë vendime mbi çështje të rëndësishme të lëvizjes kombëtare. Kështu Kongresi I i Manastirit u pasua nga Kongresi i Elbasanit (2-10.IX.1909) e nga Kongresi i II i Manastirit (mars 1910), pa përmendur kongreset e projektuara, që s'arritën të mbahen për shkak të ngjarjeve politike e të situatave të krijuara (si Kongresi i Janinës, Kongresi i Shkupit, Kongresi II i Elbasanit).

Vendimet e Kongresit të Manastirit për punë të alfabetit genë kurorezimi i një pune të gjatë prej disa shekujsh për shkrimin e shqipes, për përmirësimin e vazhdueshëm të sistemit grafik të saj, e në mënyrë të veçantë genë përfundimi i përpjekjeve të shumanshme, i punës sistematike të zhvilluar në periudhën e ndritur të Rilindjes, për t'i dhënë gjuhës sonë një alfabet sa më të përshtatshëm, të saktë e të përbashkët për gjithë shqiptarët.

Historia e alfabetit tonë është histori e gjatë dhe e ndërlikuar, e lidhur ngushtë me zhvillimin historik të vendit tonë, e jo vetëm me historinë e kulturës, por edhe me historinë shoqërore e politike, shumë herë arenë ndeshjesh ndërmjet rrymash, tendencash e pikëpamjesh të ndryshme, ku janë pasqyruar më se një herë interesat klasore e janë përpjekur të ndikojnë e të veprojnë edhe interesat politike të fuqive të huaja. Kjo histori e pasur, që meriton t'i kushtohen gjurmime e studime shkencore të imta e të thelluara, karakterizohet nga një vijë përpjekjesh për të ngritur gjuhën amtare në një gjuhë të përpunuar kulture, për të zhvilluar e fuqizuar këtë hallkë të fortë të bashkimit kombëtar të shqiptarëve gjatë shekujve, këtë mjet të rëndësishëm të zhvillimit të arësimit në gjuhë amtare e të përhapjes së diturisë në popull, nga një luftë, shumë herë e vështirë, e mendjeve përparimtare dhe masave atdhedashëse e arsimdashëse kundër pengesave e faktorëve të ndryshëm negativë ose edhe planeve e veprimeve të armiqve të popullit tonë.

Shqipja u shkrua, me sa del nga disa dëshmi e të dhëna të tjera të tërthorta, të paktën që nga fillimi i shekullit XIV¹. Ndonjë orvatje e bërë për të mohuar një traditë shkrimi të shqipes para shekullit XV, ose edhe para shekullit XVI, duke mos marrë parasysh argumentat që ekzistojnë në të mirë të pranimit të saj, s'ka asnjë bazë².

1) Shih *Historia e letërsisë shqipe I*, Universiteti shtetëror i Tiranës, 1959, f. 155-7, dhe Dh.S. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, 1865, ff. 13-17. Në to jepet edhe dëshmia e vitit 1332 e murgut Brokard, alias Guillelmus Adae, që flet për alfabet latin të përdorur të shqiptarët e ndër librat e tyre.

2) Kështu G. Schiro Junior në veprën e tij *Storia della letteratura albanese*, Milano, 1959, f. 10, s'pranon as dëshminë eksplicite të Brokardit. Nga fraza e këtij «Licet Albanenses aliam omnino linguam a latina habeant, et diversam, tamen litteram latinam habent in uso et in omnibus suis libris», duke e kuptu-

Botimet më të vjetra që njohim, janë shkruar me alfabetin latin³. Autorët tanë të vjetër të shekujve XVI e XVII, duke nisur me Buzukun, përdorin germa latine të plotësuara nga disa shenja të veçanta, të burimit, më shumë, sllav-cirilik, dhe me disa bashkime germash të thjeshta⁴. Ky alfabet, i cili nga njëri shkrimtar të tjetri njohu edhe një farë evolucion, duke u bërë më i ngulët e më i përpikët, dhe u quajt «alfabeti i vjetër i veriut», vijoi edhe në shekujt e pastajmë, pa dalë jashtë rrethit të komunitetit në të cilin kishte lindur⁵. Ai u përdor jo vetëm në disa vepra të shtypura, por edhe në shkrim të dorës e, sidomos në shekullin XIX, në ndonjë sferë të jetës praktike, në ndonjë mbishkrim, në regjistra, akte e korespondencë tregëtare⁶.

Në pasojë të rrethanave historike e të faktorëve të ndryshëm, të rolit që kishin gjuhët turko-arabe dhe greke në Perandorinë osmane si gjuhë zyrtare a fetare, dhe të faktit se në Shqipëri punonin vetëm shkolla të komuniteteve fetare ortodokse e myslimane në gjuhët greqisht e turqisht, për të shkruar shqipen u përdorën, sidomos nga shekulli XVIII, edhe alfabeti grek — ky edhe para pushtimit turk — e ai arabo-turk⁷, me gjithë

ar, pa asnjë arësye, «litteram latinam», jo si «alfabet latin», po si «gjuhë latine», ai nxjerr një përfundim të gabuar: «Dunque nel 1332 gli Albanesi (é intuitivo che si parli dei gheghi) scrivevano ed avevano libri in latino pur parlando una lingua del tutto diversa e propria alla loro gente».

Se këtu kemi të bëjmë me një interpretim fare të pabazuar, e tregon edhe versioni frëngjisht i relacionit të Brokadit: «Et ja soit que les albaniens aient une autre langue diverse de celle des latins, toutefois ils ont en usage et en tous leurs livres la letre latine». (Shih *Historia e letërsisë shqipe*, I; Dh. Shuteriqi, *vepër e cituar*, f. 13).

3) Alfabeti latin del, me të dhënat e derisotme, si alfabeti më i lashtë i përdorur për të shkruar gjuhën shqipe. Mendimi i hedhur nga H. Bariçi pa asnjë provë se përpara alfabetit latin ka qenë përdorur në Shqipëri alfabeti cirilik edhe kur shkruhej në gjuhën e popullit (gazeta «Vreme», Beograd, 1.1.1941, f. 5), s'ka asnjë mbështetje (shih E. Çabej, *Meshari i Gjon Buzukut*, Botim kritik, 1968, f. 60).

4) Alfabeti latin i Buzukut ndjek grafinë e italishtes. Ai karakterizohet nga polisemia e mjaft grafive dhe poligrafia e mjaft tingujve; më se njëherë e njëjta germë shërben për të shënuar tinguj të ndryshëm të shqipes, e i njëjti tingull shënohet me germa e grafi të ndryshme. Buzuku përdori edhe 5 shkronja të posaçme: γ, ε, ξ, ε, χ për y, z, th, e dh, c e x, q e gj. Dy prej tyre, pas mendimit të përgjithshëm, janë përkatësisht cirilike ose shformim germe cirilike; tri mund të jenë të burimit ose italian ose sllav, një gjasësisht greke. Në mjaft raste përdoren edhe digrame, p.sh. ch = k, ll = ll edhe l, gn = nj, sc = sh. Për të gjitha këto shih studimin e imët të E. Çabejt, «Karakteret e shtypit dhe grafia», në *veprën e cituar* f. 45-60.

5) Pjetër Budi (1618, 1620, 1621) solli disa thjeshtime, sistemime e ndryshime. Ndër gerrat e posaçme nuk u përdor më t për q e gj të cilat u shkruan përkatësisht me ch a chi dhe gi. U mënjaua ndonjë polisemi grafie: j jepet me y e jo me i; th e dh dallohen duke u shënuar tingulli i parë me dyfishim të shenjit përkatës etj. (J. Rrota, *Për historinë e alfabetit shqip*, 1936, f. 16-17). Pj. Bogdani (1685) dalloi ë-në nga e duke e shkruar të parën e; për ll përdorën greke. Gjon Kazazi (1743) ë-në e shënon me œ; ai ka, i pari, germën ç. (J. Rrota, *vep. e cituar*, f. 36).

6) Kështu në një epitaf të vitit 1838 në Shkodër, në një letër të Kol Rashit drejtuar Molla Mahmudit në Tiranë, 1825; në një letër të Gjokë Antonit, Shkodër 1841; në rradhua hesapesh Shkodër 1843, 1846-7, 1847-1849, 1848 (Dh. Shuteriqi, *vep. e cit.* f. 133, 151, 156, 160, 170, 176-7). Në Arkivin Qendror Shtetëror të RP të Shqipërisë ka edhe një numër aktesh zotërimi pronash me shkrime anësore shqipe me alfabetin e vjetër të veriut.

7) Alfabeti grek ngjan të jetë përdorur për shkrim të shqipes relativisht herët. Po, me përjashtim të Perikopesë së Ungjillit, për datimin e përpikët të së cilës mendimet janë të ndara (disa e mbajnë si të shekullit XIV, të tjerë si të fundit të shekullit XV ose të fillimit të shekullit XIX), botimet a shkrimet që na kanë arritur, janë të shekullit XVIII e XIX. Këtë alfabet përdorën për shkrimin e fjalëve

papërshtatësinë e tyre, në mënyrë të veçantë të këtij të fundit, për të dhënë sistemin fonetik të shqipes.

U ndoq edhe një rrugë tjetër: ajo e krijimit të alfabeve të veçanta. Duke u nisur nga variante të shkrimit të dorës alfabetesh të huaja, greke a sllave, duke ju sjellë atyre modifikime në përshatje me kërkesat e gjuhës shqipe e duke u dhënë një fytyrë të re germave, saqë ndonjë prej tyre, për një kohë, u kujtua si shumë i lashtë dhe origjinal, u krijuan në shekullin XVIII, — gjasësisht duke filluar nga mezi i tij, por ka mundësi edhe më përpara, — dhe në fillim të shekullit XIX, një sërë alfabetesh të tilla, disa prej të cilave edhe i njohim, si atë të Anonimit të Elbasanit, të dorëshkrimit të Kostë Beratit, të mjekut Vellara etj.⁸ Orvatja më e rëndësishme qe ajo e Theodor Haxhifilipit, e fundit të shekullit

shqipe voskopopjarët Theodor Kavalioti (1760) dhe Dhanil Haxhiu (1802) në glosarët disa gjuhësh të tyre, Konstandin Berati (rreth vitit 1768) etj. Ai u përdor në botimet shqipe të Ungjillit në Korfuz (1824, 1827) etj. dhe në Athinë (1858), në botimin e gazetës «Pelazgos» (1861-2) nga A. Byku, — i cili botoi edhe një abetare të shqipes me këtë alfabet «Gramë për shqiptarët» (1861) nga A. Kullurioti në gazetën «I foni tis Alvanias, Zëri i Shqipërisë» (1879-80) etj. Alfabeti turko-arab na del i përdorur për shkrim të shqipes që nga shekulli XVIII e vijon në shekullin XIX në vjershat e bejtexhinjve (Nezim Frakulla, Sulejman Naibi, Hasan Zyko Kamberi, Muhamet Kycyku, Shahin e Dalip Frashëri etj.), në ndonjë copë proze e në ndonjë glosar, të gjitha në dorëshkrim. U botua e litografuar ndonjë gjë e rrallë, si abetarja e Daut Boriçit, Stamboll, 1861.

8) Më i vjetri ndër alfabetet e posaçme rezulton gjer më tani ai i përdorur në përkthim të disa fragmenteve ungjijsh të një autori që u quajt Anonimi i Elbasanit. Duket i shekullit XVIII. Alfabeti është i përbërë prej 40 germash, i mbështetur në glagolitikun sllav. Shih për të: I. Zamputi, *Disa shënime rreth alfabetit të dorëshkrimit të Anonimit elbasanas*, në «Buletin i Institutit të Shkencave», nr. 1, 1949, ff. 55-70; po ai, *Dorëshkrimi i Anonimit të Elbasanit*, transliterim, transkriptim me komente, po aty, nr. 3-4, 1951, ff. 64-130 me faksimile të shumta dhe me tabelën e alfabetit; Dh. S. Shuteriqi, *Dhaskal Todhri*, në «Buletin i shkencave shoqërore», nr. 4, 1954, boton alfabetin e Anonimit të krahasuar me alfabetet e tjera origjinale shqipe; po ai, *vep. e cit.* ff. 61-63; M. Domi, *Rreth autorit dhe kohës së dorëshkrimit elbasanas me shqipërim copash të ungjillit*, në vëllimin «Konferenca e parë e studimeve albanologjike», Tiranë, 1965, f. 270 e vv.

Po me bazë sllave glagolitike është edhe alfabeti prej 37 germash, tabela e të cilit figuron në dorëshkrimin e Konstandin Beratit rreth vitit 1768.

Alfabeti i posaçëm i Jan Vellarait, mjek i të birit të Ali pashë Tepelenës, Veliut, e poeti i njohur i letërsisë greke të fillimit të shekullit XIX, në disa shënime gramatikore dorëshkrim (1801) të ruajtur në Bibliotekën Nacionale të Parisit, përdor për shqipen një alfabet të posaçëm prej 30 shkronjash të krijuar sipas fytyrës së alfabeve latin e grek, duke ndryshuar disa shkronja ose duke u dhënë vlera të ndryshme. Po në këtë dorëshkrim figuron edhe një letër shqip e Vellarait drejtuar një mikui dhe shkruar me këtë alfabet, ç'ka dëshmon për një farë përhapjeje të tij. Për të shih Dh. S. Shuteriqi, *Gramatika e Jan Vellarait*, në «Letërsia jonë», Tiranë, 1950, 8, f. 50 v.; po ai, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, ff. 109-111. Maltebrun (Géographie universelle, v. IV, botim i 5, Paris, 1844, f. 338 e 340) e kujtoi shumë të vjetër këtë alfabet.

Më i njohuri e më i përhapuri ndër to qe ai i Theodor Haxhifilipit a Dhaskal Todrit. Ai ka 52 germa. Gj. Pekmezi ka mbrojtur tezën se ai është një korsi grek i shekullit XVIII i stilizuar në mënyrë origjinale («Vorläufiger Bericht über das Studium des albanesischen Dialektes von Elbasan, në «Anzeiger des philos.-hist. Classe», Wien, 1901), ndërsa të tjerë e kanë afuar me alfabetin glagolitik sllav. G. G. von Hahn (Albanesische Studien I) dhe L. Geitler («Die albanesischen und slawischen Schriften, Wien, 1883»), e pandehën shumë të vjetër duke e quajtur i pari «alfabeti pelazgjik» e i dyti si burim të alfabetit glagolitik sllav. Ky alfabet u përdor jo vetëm në shkrimet e Todrit, po edhe në radhoni hesapesh e kronika familjare të Elbasanit që nga viti 1795, në shkrime fetare e të tjera, edhe mjaft lista fjalësh, shprehjesh e frazash shqipe me korespondueset e tyre në gjuhët italisht, gjermanisht, çekisht, polonisht e anasjelltas, të shkruara para 1823 nga tregëtari

XVIII, alfabeti i të cilit vijoi të përdoret edhe gjatë shekullit XIX jo vetëm në shkrime fetare, por edhe në kronika familjare e në regjistra tregëtie në Elbasan e. sipas ndonjë dëshmie, në një masë më të vogël edhe në Berat. Këto alfabete shfaqen e shumohen tamam në një periudhë kur nisin të zhvillohen procese të rëndësishme ekonomiko-shoqërore dhe politike në Ballkan, edhe në vendin tonë, kur zënë të mëkëmben mjeshtritë e të marrë një farë hovi tregëtia, kur një numër qytetesh të Shqipërisë gjallërohen dhe bëhen qendra ekonomike e politike, kur zënë të depërtojnë në disa rrethe, sado të kufizuara, ide iluministe, dhe kur nis në disa popuj të Ballkanit një lëvizje emancipimi spiritual nga he-lenizmi. Alfabetet e posaçme gjejnë përhapje në shtresa zejtare-tregtare të qyteteve të ndryshme të Shqipërisë së jugut e të mesme. Në këto rrethana ky fenomen ka kuptimin e një orvatjeje, të vetvetishme a të vetëdijshme, për të afirmuar kombësinë shqiptare, për të vënë në dukje individualitetin kombëtar. Në bazë të këtyre orvatjeve qëndron mendimi se shqiptarët, duke qenë një popull më vete, me gjuhë të tyre, duhej të kishin edhe një alfabet më vete.

Arbëreshët e Italisë shtinë në punë alfabetin latin, duke u mbështetur në sistemin e shkrimit të italishtes, me bashkime germash edhe me ndonjë germë greke, duke pasur edhe ndonjë takim me alfabetin e vjetër të veriut⁹.

Kështu, gjer në pragun e Rilindjes, ne kemi vetëm alfabete të përdorura në rrethe kulturore fetare të ndryshme, dhe shkrimi i shqipes karakterizohej nga mungesa e theksuar e njësisë, pasqyrim ky i gjendjes shoqërore-politike të popullit tonë, përcaktuar nga kushtet historike të rëndit feudal, të pushtimit të huaj dhe të përçarjes fetare. Edhe këtu rindasve u dilte një detyrë e madhe: t'i jepnin shqipes alfabetin kombëtar të përbashkët për gjithë shqiptarët.

Në një frymë të re, në një plan panshqiptar e qartësisht kombëtar, shtroi çështjen e alfabetit ideologu i parë i Rilindjes sonë iluministi Naum Veqilharxhi (1797-1859), shprehës i aspiratave të rretheve të përparua-

elbasanas Simon Kazanxhiu, që kishte lidhje tregëtie me vende të ndryshme të Evropës Qendrore, Perëndimore e Lindore. Për gjithë këto shih Dh. S. Shuteriqi, *Dhaskal Todhri*, në «Buletin për shkencat shoqërore», nr. 4, 1954, ff. 35-55, me një tabelë të alfabeteve origjinale shqipe, duke përfshirë edhe atë të Hoxha Tahsinit; po ai, *Shkrime të Dhaskal Todhrit dhe të pasardhësve të tij albasanas...*, po aty, nr. 1, 1959, ff. 180-182; po ai, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, ff. 101-2, 115, 117, 130, 130-131.

9) Autori më i vjetër arbëresh, Lekë Matrënga (1592) shtiu në përdorim alfabetin latin të shkrimit të italishtes; ka një numër gjermash me vlera dyfishe, po ashtu edhe digrame a trigrime (p.sh. *gn = nj; cgh, cg, cghi = gj*); ë-në e shënoi me *ae*, dhe ndërthëmboren e shurdhët, si sot, me digramën *th*. Si autorët e vjetër të Shqipërisë edhe ai përdor zanoret e dyfishuara për të dhënë gjatësinë.

A. Santori (Il Canzoniere albanese, Napoli 1839), përdor *ë, dh, th, j, k, g, sh*, me vlerat që kanë sot. (Dh.S. Shuteriqi, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, f. 153), po në një vepër tjetër të tij të vitit 1849 për *ë* përdor *y*.

Jeronim de Rada gjatë veprimtarisë së tij të gjatë, i solli herë pas here ndryshime alfabetit të tij. Në botimin e Milosaos, 1873, ai përdor alfabetin latin në fyturë të atij italian me disa germa greke (*δ = dh, θ = th, χ = z, ζ = z*); ka disa digrame si *nj = nj, sh = sh, zh = x, gc = g* etj.; ka *ë = ë*, po edhe e. Më pas ai përdor *th* e *dh* me vlerat e sotme. (J. Rrota, *vep. e cituar*, ff. 48-50, 52).

Për t'u shënuar është edhe alfabeti i përdorur nga arbëreshi i Kalabrisë Daniele Cortese në një vjershë shqipe të tij botuar në një përmbledhje të vitit 1638; ka dy gjërmat cirilike që i kanë edhe Budi e Bardhi për *z* e *u*; ka, i pari, *dh* për të shënuar ndërthëmboren e zëshme, si sot, po edhe të pazëshmen përkatëse (Dh.S. Shuteriqi, *Një tekst i panjohur shqip i vitit 1638*, në rev. «Nëndori», 1958, ff. 148-154).

ra të klasës së re që po ngrihej, të borgjezisë. Atë ai e vështroi në dritën e bashkimit kombëtar dhe të përhapjes së kulturës në masat e popullit, si pjesë përbërëse të një programi të gjerë për zgjimin kombëtar. Shqiptarët, sipas tij, nga gjendja e mjeruar e prapambetja ku i kanë katandisur pushtimet e huaja dhe pasojat e tyre, dhe nga rreziku i shkombëtarizimit do të shpëtojnë duke fituar kulturën, po kulturën një popull mund ta marrë në masë vetëm në gjuhën amtare. Prandaj detyrë e parë ishte, sipas tij, që të shkruhej e të lëvrohej gjuha amtare, të përhapej arësimi shqip, të zhvillohej letërsia shqipe. Alfabeti i posaçëm që krijoi Naumi, pa ndonjë lidhje me asnjë nga alfabetet e përdorura gjër atëhere, për të qenë i pranueshëm nga gjithë shqiptarët¹⁰, gjeti një pritje të mirë në disa vise të Shqipërisë dhe jashtë saj¹¹. Ai pati një farë përhapjeje në Shqipërinë e Jugut me abetarin e parë të gjuhës sonë që arriti të botojë më 1844 e të ribotojë në formë më të zgjeruar më 1845. me shumë mundime, ky atdhetar i zjarrtë. Po, për arësyje të ndryshme, ndër të cilat mund të përmenden ndjekjet e Patrikanës e të qeverisë otomane, gjendja

10) Ky synim i vetëdijshëm i N. Veqilharxhit del qartë në fjalët që shkruan për alfabetin e tij shkrimtari e iluministi i njohur rumun I. Eliade Rădulescu (1802-1872) në gazetën e Bukureshtit «Curierul Românesc», 1846, f. 175: «Në vitin 1844 ka dalë një abetare dhe në vitin 1845 një shkurtoare e historisë biblike nga Zoti Naum P. Veqilharxhi, çpikës i një alfabeti që i përshtatet natyrës së gjuhës shqipe dhe rrethanave në të cilat ndodhet ky popull. Ky alfabet ka më shumë mundësi të pajtojë mendimet që i ndajnë banorët e Shqipërisë, të cilët ndjekin tre rite të ndryshme: disa janë të krishterë lindorë [ortodoksë], të tjerë të krishterë perëndimor [katolikë] dhe të tjerë muhamedanë. Shkronjat greke do të kënaqnin vetëm ata të rritit grek; shkronjat latine ata të rritit katolik dhe do të shkaktonin pakënaqësi në dy pjesët e tjera të rëndësishme. Shkronjat e shpikura nga zoti Naum mund t'i pajtojnë tërë mendimet, ato edhe u priten me kënaqësi nga të tri pjesët e kombit. Meriton të kihet parasysh dhe të lavdërohet shumë përpjekja dhe zelli i zjarrtë me të cilin ky burrë i ka kushtuar 20 vjet të jetës shqipjes së këtyre shkronjave dhe përkthimit të lloj lloj librave të përshtatshme...» (Përkthimi i A. Gjergjit).

11) Pritje veçanërisht entuziaste gjeti abetari në borgjezinë korçare siç del nga letra dërguar atij prej Korçë më 22.IV.1845 e nënshkruar nga Thanas Paskali (P. Pepo, *Një letër e korçarëve e vitit 1845 dërguar N. Veqilharxhi në Rumani*, «Studime filologjike», nr. 1, 1966, f. 203). Alfabeti i Veqilharxhit u përhap në Korçë e në krahinën e saj, në Përmet, në Berat. Ai u njoh edhe ndër shqiptarët jashtë Shqipërisë, në radhë të parë ndër ata të Rumanisë, si edhe ndër të huaj, duke bërë jehonë ndër shumë ambiente. Arbëreshët e Italisë muarën shpejt njoftim për të, siç tregojnë fjalët e V. Dorsës *Su gli albanesi...*, Napoli, 1847, f. 131): «Nel 1844 nel Principato di Valachia si è fuso un nuovo alfabeto albanese, ingegnossimo e di un tipo speciale nuovo...». Shtypi rumun i kohës shkroi me shumë simpati për këtë nismë e për popullin shqiptar. Eliade Rădulescu, që ngjan të ketë njohur së afërmi Veqilharxhin e të ketë pasur miqësi me të, u drejton një thirrje të nxehtë shqiptarëve të Vllahisë për të përkrahur bashkatdhetarin e tyre që po përpiqet t'i verë themel e para letërsisë kombëtare. Ja seç shkruan ndër të tjera edhe «Gazeta de Transilvania» e Brashovit, VII, 26.IV.1845: «Por ja që shekulli XIX, ky shekull i dritave, zgjon edhe midis shqiptarëve një burrë të ndezur nga dashuria për kombin e vet dhe për ndriçimin e tij, i cili nuk kursen mundimin, pasurinë dhe kohën prej më shumë se 20 vjetsh deri sa rradhit një alfabet të përshtatshëm, harton një filladhe, të cilën edhe e shtypi, dhe përkthen disa libra të tjera në gjuhën e tij kombëtare. Ky burrë është zoti Naum Panajot Veqil Harçi, i lindur në Vithkuq të Kolonjës.

33 tinguj të ndryshëm ka gjuha shqipe dhe zotëria e tij formon po aq shenja ose gërma për ta. Kam dëgjuar se gjetja e zotit Naum u prit me një ngrohtësi dhe gëzim që s'pritej, aq sa një numër i madh shqiptarësh filluan të shkruajnë në gjuhën e tyre me gërmat e formuara nga zotëria e tij. Është e dëshirueshme që mbi këtë ndërmarrje kaq të dashur e të vlefshme të tërhiqet vëmendja edhe e shqiptarëve të tjerë që banojnë në vende të tjera, shumë nga të cilët janë në gjendje shumë të mirë ekonomike. Kombi i shqiptarëve ka shpirt dhe zgjuarësi: si është e mundur që burrat e tij të durojnë edhe në të ardhmen mendimin përulës të të huajve se ata s'kanë as alfabet, as letërsi. Pra burra shqiptarë,

e prapambetur e vendit dhe vështirësitë praktike e teknike që paraqiste shkrimi e botimi me të, ky alfabet nuk u përdor në botimet shqipe të mëpastajme¹².

Përpjekje të reja për caktimin e një alfabeti që të njihej e të pranohej nga të gjithë shqiptarët si alfabet kombëtar u bënë në dhjetëvjetëshin e shtatë të shekullit të kaluar. Idetë e Veqilharxhit rimerren nga një grup shqiptarësh të Stambollit. Ndihet nevoja e krijimit të një shoqërie letrare, që do të kujdesej për të botuar libra shqip e për të hapur shkolla shqipe. Si punë paraprake dilte përpunimi i një alfabeti të përshtatshëm të përbashkët. Orvatje të njëpasnjëshme u bënë më 1867, 1869, 1871, 1872, 1877¹³, duke vijuar për vite të tëra takime, shkëmbime mendimesh, mbledhje komisionesh. Në këtë veprimtari dalloheshin njerëz si Konstandin Kristoforidhi, Pashko Vasa, Hasan Tahsini, në fillim edhe Ismail Qemali, e më pas Jani Vretua dhe Sami Frashëri. Puna u ndërpre sa e sa herë nga masat e Qeverisë otomane¹⁴, herë herë edhe nga divergjencat e pikëpamjeve të pjesëmarrësve. U zhvillua një luftë e ashpër mendimesh, duke

përqafoni këtë produkt të paçmuar të paqës, mbillni edhe në gjirin e kombit tuaj shkencat dhe artet e bukura...» (përkthim i A. Gjergjit).

Alfabeti i N. Veqilharxhit u njoh shpejt edhe në bōtën shkencore, sidomos në atë gjermane. Ai figuronte në veprën e A. Auer, *Die schriftzeichen des gesammten Erdkreises in 104 alphabeten*, Wien, 1847. Gjatë me të merret L. Geitler, *Die albanischen und slavischen Schriften*, Wien, 1883, (Dh.S. Shuteriqi, *vep. e cit. f. 164*).

12) Në pasqyrë e tij jepet në tabelën e krahasuar të alfabeteve origjinale të shqipes, Dh.S. Shuteriqi, *Dhaskal Todri*, në «Buletin për shkencat shoqërore», 4, 1951. Në të Geitler gjeti një bazë sllave, e kuptueshme po të marrim parasysht se rumunët, në mes të cilëve jetonte N. Veqilharxhi, përdornin në atë kohë alfabetin cirilik.

13) Shih *Historia e Shqipërisë*, II, ff. 97-8, 105-106 që bën fjalë për tri sërë përpjekjesh, më 1864, 1867 e më 1871, dhe f. 85 për qenjen e një shoqërie kulturore shqiptare në Stamboll në dhjetëvjetëshin e gjashtë. Po ashtu edhe Dh.S. Shuteriqi, *Konstandin Nelko Kristoforidhi 1830-1835*, në «Buletin i Institutit të Shkencave», nr. 1-2, 1950, f. 9, 11, 13, 34. Shih edhe Kr. Frashëri, *Shoqëri e të shtypuri shkronja shqip*, në «Buletin për shkencat shoqërore» 4, 1954, ff. 155-156, që flet për përpjekje të bëra në vitet 1864, 1870, 1877. Është nevojë të hidhet një dritë më e plotë mbi këto përpjekje e të saktësohet më shumë kronologjia e zhvillimi i tyre, duke ballafaquar dëshmitë e ndryshme të njohura, të cilave kohët e fundit, u është sthuar ndonjë e re. J. Vretoja, në bazë të kujtimeve të Kristoforidhit, jep dy data të ndryshme të iniciativës së parë: 1864 e 1867. Në letrën shkruar S. Kolesë nga Bukureshti më 23.X.1893 thotë: «Që nga 1864 shumë mbledhje e mendime prej shqiptarësh orthodhoksë e muhamedanë e katolikë u bënë ndë Konstandinopolë për allfavitë të plotë e të bukurë e të njohurë për gjuhënë shqip». Për këto mbledhje ai flet gjerë e gjatë në veprën — dorëshkrim të tij «Sqepsis...», të shkruar në vitet e fundit të shekullit XIX, ku e nis këstu historinë e këtyre përpjekjeve: «Pra nevojën e përdorimit të një alfabeti të vetëm e të përbashkët, i cili të ketë aqë shkronja të thjeshta njëformësa sa zëra të thjeshtë e të pandarë ka gjuha jonë shqipe e ndjenë në vitin 1867 njerëz të shquar të kombit tonë që ndodheshin e rrinin në Stamboll». Shahin Kolonja («Shkrimi, këndimi, abetare e gjuhës shqip», te gazeta «Drita» e Sofjes II, 33, 5.XII.1903) në bazë të kujtimeve të një bullgari plak që kishte punuar në shoqëritë të protestanëve në Stamboll bashkë me Kristoforidhin, flet për dy orvatje të bëra, e para, në kohën e vezirit Ali Pasha dhe, e dyta të Midhat Pashës. I pari ka qenë vezir i madh nga 1867 më 1871, i dyti më 1873-4 dhe në fillim të 1877. Këto të dhëna e rrethanat historike na bëjnë që të kemi shumë rezerva ndaj datës 1864 e të marrim si përpjekje të parë atë të vitit 1867.

14) Këto përpjekje në ndonjë moment u duk sikur gjetën një farë mbështetje të kufizuar në disa rrethe qeveritare turke më largpamëse. Për to u bë fjalë edhe në shtyp; u shpresua në ndonjë çast edhe në daljen e ndonjë leje qeveritare. Për formimin e një komisioni për alfabetin e shqipes njoftonte gazeta e Stambollit «Courrier d'Orient» e 2.III.1870, nga e merr edhe A. Dozon, *Manuel de la langue chqipe ou albanaise*, Paris, 1878, f. 167. E përmend edhe Dh. Kamarda në A. Dora *d'Istria gli Albanesi*, Livorno, 1870, f. 21, shën. 1; «Annunziavano i giornali fin dal

u ndeshur pikëpamje të ndryshme, gjersa të caktoheshin kritere të pranueshme nga të gjithë¹⁵. U hodh poshtë që në fillim mendimi i disa feualdëve, të mbështetur edhe nga Porta e Lartë, për të marrë e plotësuar alfabetin arab, po ashtu edhe mendimi për të shkruar shqipen thjesht me alfabetin e greqishtes. Duke qenë se asnjë alfabet nuk mjaftonte për të dhënë gjithë tingujt e shqipes, u shfaqën mendime të ndryshme për alfabetin që do të merrej si bazë, për kriteret që do të ndiqeshin për plotësimin e tij e për mënyrat konkrete se si do të zbatoheshin ato. Nuk gjeti mbështetje pikëpamja e Hasan Tahsinit se duhej krijuar një alfabet i posaçëm, i cili do t'i jepte më mirë, më saktë, e në një mënyrë sa më të thjeshtë tingujt e shqipes e do të mund të pranohej më lehtë prej gjithë shqiptarëve¹⁶. Pashko Vasa ishte për një alfabet thjesht latin, duke plo-

principio del corrente anno 1870, che il governo turco aveva nominato una commissione per fissare un alfabeto ad uso degli schipetari.»

Lajme edhe më të plota jep shkrimtari e militanti iluminist i Rilindjes bullgare P.R. Slavejkov, — që punoi disa vjet në Shoqërinë Biblike po në atë kohë që punonte edhe Kristoforidhi e, si pasojë, kishte mundësi të ishte mirë i informuar, — në gazetën bullgarisht «Makedonia», të datës 27.I.1870 që nxirrte në Stamboll: «Komisioni që kishte qenë ngarkuar të krijonte një alfabet për gjuhën shqipe i dha fund punës së tij; tani nuk pritet veçse dekreti i sulltani për të futur në përdorim këtë alfabet. Alfabeti i ri është shumë i thjeshtë. Në përpilimin e tij, Komisioni u është shmangur anomalive e shregullimeve që ndeshen në shumë alfabete evropiane» (Str. Dimitrov, *L'Albanie et la Renaissance albanaise dans la presse dirigée par P.R. Slavejkov*, në «Etudes balkaniques», VII, 1968, Sofia, f. 204.

Po të gjitha këto shpresa qenë iluzione të kota. Jo vetëm që s'doli dekret nga sulltani për të lejuar shkrimin e shqipes ashtu si u ishte lejuar edhe gjithë kombësive të tjera të Perandorisë osmane për të shkruar gjuhët e tyre, po me kërcënime e me masa të ndryshme u kërkua të mbytej edhe puna e nisur. Ndërhyrja e fuqive reacionare dhe e armiqve të popullit shqiptar, paqëndrueshmëria, si edhe prapamendimet edhe të atyre rretheve që dukej sikur kishin një farë mirëkuptimi ndaj kërksave kulturore kombëtare të popullit shqiptar, s'i dhanë mundësi kësaj lëvizjeje të shqiptarëve të Stambollit të shkonte përpara. Në maj 1874 autoritetet turke edhe e arrestuan në vilajetin e Janinës anëtarin e komisionit të sipërpërmendur, Hasan Tahsinin, pse shpërndante alfabetin e posaçëm të krijuar prej tij për shkrimin e shqipes (A. Dozon, *vep. e cit.*)

15) Një ide të kësaj lufte e të pikëpamjeve aq të ndryshme që u ndeshën në të na e jep Jani Vretoja në veprën-dorëshkrim të tij greqisht *Sqepsis peri grafis tis sqipetariqis gllossis* (= *Mendime për shkrimin e gjuhës shqipe*. Dorëshkrimi ruhet në AQSH. Ka ardhur aty nga Biblioteka e Korçës, fondi Spiro Dine. Ka 210 f. radhoi dhe është e pambaruar. Ka të shkruar vitin 1895 dhe dosja përkatëse mban shënimin se është filluar më 1895 e ka vijuar gjer më 1900. Puna, si duket, është ndërrprerë me vdekjen e autorit. Mund të dallohen në të tri pjesë: 1) Gjuha dhe përbërja tingëllore e saj; formimi i gjuhëve; historia e alfabeve që nga finikët; 2) Shkrimi i shqipes gjer më tani; autorët e veprat e tyre, gjuha e alfabeti, duke filluar me P. Budin; është një farë shkurtoreje e historisë së alfabetit shqip; 3) Histori e përpjekjeve të shqiptarëve të Stambollit në shekullin XIX për të shkruar gjuhën shqipe e për t'i dhënë kësaj një alfabet të përbashkët. Kjo e fundit, e shkruar në bazë të kujtimeve personale e të thënjeve të K. Kristoforidhit, paraqet interes të veçantë për historinë e alfabetit të shqipes e për historinë e Rilindjes sonë; ajo ze afër gjysmën e dorëshkrimit.

16) Hasan Tahsin i denë e tij edhe e realizoi duke hartuar një alfabet me gërma të posaçme, që e botoi në formë të një table. Një riprodhim të tij kemi te Dh.S. Shuteriqi, *Dhaskal Todhri*, në «Buletin për shkencat shoqërore», 4, 1954. Konsulli austro-hungar në Vlorë duke folur për kërkesën e Lidhjes së Prizrenit për t'u futur shqipja gjuhë zyrtare në Shqipëri, e për shpresën që ka njerëzia se do të hapen shkolla shqipe, në raportin e tij të datës 12.XII.1878 shton: »Mësimi fillor në gjuhë shqipe nuk do të gjejë aq shumë vështirësi, si kujton ndonjë, pasi qysh prej 15 vjetësh janë duke u përdorur alfabete shqipe-epirote si me gërma latine ashtu edhe me gërma greke, të cilat janë përhapur mjaft, bile ka nja 6 vjet një profesor muhamedan në Paris me emrin Haxhi Tahsin, ka përpiluar një abece shqip dhe disa copë i ka shpërndarë në Stamboll». («Leka», 7-8, 1939, f. 184).

tësuar germat e thjeshta latine me bashkime germash si në mjaft gjuhë të Evropës e si praktikohesh gjerë edhe në alfabetin e vjetër të veriut¹⁷.

Po më shumë përkrahës pati parimi i dhënjes së një tingulli vetëm me anë të një shkronje, përdorimi vetëm i shkronjave të thjeshta. Duke ndjekur këtë parim e duke mos mjaftuar asnjë alfabet për gjithë tingujt e shqipes, nuk mbetej veçse të plotësoheshin germat e njërit alfabet me të një tjetri, ose me germa të shoqëruara me shenja diakritike. Gjeti mbështetje parimi i parë¹⁸. Këtë parim kishte ndjekur edhe Konstandin Kristoforidhi në përkthimet e librave fetare të tij, të botuara nga shoqëria biblike. Në versionin gegërisht u përdor alfabeti latin i plotësuar me disa germa greke si $\delta = dh$, $\theta = th$; në versionin toskërisht alfabeti grek i plotësuar me disa shkronja latine si *b, d, j*, duke shtënë në përdorim si në njërin, ashtu edhe në tjetrin rast edhe shenja plotësuese, p.sh. *j, k, v, p* etj. dhe *g', k', n', r' s'* etj. për *gj, q, nj, rr, sh*. Masat ndaluese të qeverisë osmane nuk lejuan që të shpihej gjer në fund puna e të zgjidhej çështja e alfabetit para vitit 1879, kohë e Lidhjes së Prizrenit dhe e krizës lindore. Në fillim të këtij viti, një komision i kryesuar nga Sami Frashëri dhe i përbërë nga Pashko Vasa, Hasan Tahsini, Jani Vretoja, Koto Hoxhi, pas disa bisedimesh ku muarën pjesë edhe Kristoforidhi e të tjerë, pranoi alfabetin e parashtruar nga Sami Frashëri¹⁹, që u miratua edhe

17) Jani Vretoja, ndër të tjera, në diskutimet në komision vë në gojë të Pashko Vasës këto fjalë: «Po kështu edhe ne shqiptarët, duke qënë evropianë, mundemi të marrim alfabetin e mirë dhe të bukur latin dhe të shkruajmë gjuhën tonë, dhe zërat e thjeshtë e të pandarë të saj që teprojnë, t'i shkruajmë me dyshkronjëse sipas sistemit të sanksionuar të evropianëve. Bile një pjesë prej nesh e kanë marrë alfabetin latin dhe shkruajnë kështu prej qindra vjetësh, siç dëshmojnë librat e ndodhura të shtypura gati para treqind vjetve.» Dhe më tutje: «Dhe duhet të dimë dhe këtë: se, po të marrëm alfabetin latin si evropianët, ata prej nesh që shkruajnë libra, do të mund t'i shtypin shkrimet e tyre me lehtësi në shtypshkronjat me germa latine që ekzistojnë në gjithë qytetet e Evropës, kurse, duke menduar e diskutuar për të shpikur shkronja të reja për shkrimin e gjuhës sonë, edhe koha kalon, edhe, kur të vendosim më në fund ndonjë lloj shkronjash të reja, të shëmtuara dhe të panjohura, do të shpenzojmë jo pak të holla për t'i ndërtuar ato... dhe kështu shkrimtarët nuk do të kenë mundësi t'i shtypin veprat e tyre me lehtësi.»

Pashko Vasa edhe e hartoi një alfabet thjesht latin prej 35 shkronjash, të cilin edhe e botoi («L'alphabet latin applique à la langue albanaise, Constantinople, Imprimerie du Courrier d'Orient, 1878, f. 16).

Ky alfabet ka 9 digrame: *dh, th, gj, nj, sh, zh, xh, lh (=ll), rñ (=rr)*. Ka *v* e *w*. Për *e* ka *é*, e për *ë*, *c* për *ç*, *x* për *zh*, *zh* për *x* e *c*. Si shihet është mjaft i afërt me alfabetin e përpunuar më vonë në Kongres të Manastirit.

18) Jan Vretoja në veprën e cituar jep gjerë e gjatë mendimet që ka shprehur e pikëpamjet që ka mbrojtur në diskutimet për përcaktimin e alfabetit të shqipes. Është kundërshtar i rreptë i përdorimit të digrameve. Nuk pëlqen as shenjat diakritike. Është për alfabetin grek të plotësuar me një numër germash latine, po e quan të nevojshëm përdorimin e njëkohshëm edhe të alfabetit latin të plotësuar me shkronja greke. Pretendon se me këtë mendim ishte edhe Kostandin Kristoforidhi e se u bashkua edhe vetë Pashko Vasa, ndërsa Hasan Tahsini ishte i një mendjeje me të për parimin e gërmave të thjeshta, po jo për formën e këtyre.

Këto thënje të Vretos pjesërisht nuk vërtetohen nga të dhënat e mëvonshme. P. Vasa nuk heq dorë nga alfabeti i tij latin me digrame. Edhe Kristoforidhi në letrën e drejtuar nga Elbasani më 28 janar 1888 N. Naços (botuar te «E përdyjavëshmja e gazetës së Korçës», 2, 30.I.1927, f. 25) çfaq për alfabetin latin, pse me të nuk mund të botohen kudo, e s'i pëlqen alfabeti i Stambollit, të cilin e quan «Alfabeti i Vretos». Divergencat e mendimeve u shprehën edhe në mbledhjet e vitit 1879, po u kapërcyen shpejt për hir të rrethanave që kërkonin t'i jepej një zgjidhje e menjëhershme çështjes së alfabetit.

19) Në formën e tij përfundimtare alfabeti i Stambollit del vepër e Sami Frashërit. Jani Vretoja pretendonte se ai ishte hartuesi i këtij alfabeti. E vërteta është se Vretoja e kishte gati një projekt të alfabetit shqip që më 1877-78. A. Uçi, (Jani Vretoja, Tiranë, 1965, ff. 23-24), thotë: «Po më 1877 Vretua kishte përgatitur projektet

nga «Shoqëria e Shkronjzave» e Stambollit, që u formua pas disa muajsh, duke u bërë kështu alfabeti kombëtar i shqipës. Germat e thjeshta latine plotësoheshin në këtë alfabet me një numër germash greke ose me germa latine e greke të ndryshuara dhe me dy germa me shenja diakritike²⁰. I mbështetur në parimin «një tingull me një germë, dhe një germë për një tingull» ai mbështetej në parime shkencore të drejta, po s'ishte homogjen për nga përbërja e shenjave. Brenda një kohe të shkurtër nga S. Frashëri, J. Vretoja, Pashko Vasa dhe Koto Hoxhi u hartua edhe abetari (Alfabetare e gluhësë shqip, Konstandinupojë, 1879) që u shtyp në 20.000 kopje e që u shpërnda në të gjithë anët.

Përpunimi dhe suksesi i këtij alfabeti që një fitore e madhe e kulturës shqiptare e lëvizjes sonë kombëtare. Ai u bë alfabeti kryesor i Rilindjes sonë, i shumicës dërmuese të botimeve të saj në dy dhjetëvjetëshet e fundit të shekullit të kaluar. Ai u përhap gjerësisht në Shqipëri të jugut e të mesme, po jo në Shkodër, ku kleri katolik, me partikularizmin e tij, mbajti alfabetin e vjetër.

I thjeshtë në të shkruar dhe i saktë, ky alfabet, që u quajt i Stam-

e alfabetit shqip dhe ua kishte dërguar për aprovim Sp. Dines, Th. Kreit, Th. Mitkos në Egjipt. Ndërsa ky i fundit nuk e aprovonte këtë alfabet, Sp. Dinua dhe Th. Kreji e përkrahin...». Th. Krei në një dorëshkrim të tij greqisht (më parë në bibliotekën e Korçës) mbi alfabetet e shqipes, përkrahuan gjerë e gjatë alfabetin e Vretos të vitit 1878 prej 34 shkronjash. S'patëm mundësi ta konsultonim gjatë hartimit të këtij artikulli. A. Uçi (*vep. e cit.*, f. 28) njuh Vretos si autor të alfabetit të Stambollit, sigurisht i mbështetur në ndonjë thënjë të dorëshkrimeve të tij: «Si përfundim u aprovua alfabeti i përgatitur nga J. Vretua që mbështetej kryesisht në alfabetin grek dhe latin». Edhe në *Memoriet e mia* të Visar Dodanit (Konstanca, 1930, në fotografimin e Vretos pas f. 20) shënohet: «Pas të thënet të ti ky ka krijuar abecenë shqip trazuar me greqishte, sllavishte dhe latinishte dhe të atillën me arësye që të pajtonjë orthodhoksinë...». Edhe Kristoforidhi, si e pamë, në letrën e tij drejtuar N. Naços më 1888 e quan «alfabet të Vretos». Ky alfabet nuk përkon nga shumë anë me alfabetin që mburon J. Vretoja në bisedimet e zhvilluara në Stamboll e që parashtron ai në veprën dorëshkrim të tij. Burime të tjera e nxjerrin shkoqur si të Samiut. Edhe opinioni i përgjithshëm që ka ekzistuar e njëj si të Samiut. Prandaj ky alfabet u quajt edhe alfabeti i Frashërit.

Mund të thuhet se alfabeti i 1879 shfrytëzoi gjerësisht punën e zhvilluar gjer atëhere, pati parasysh mendimet më të arësveshme që qenë shprehur e përfundimet që qenë arritur, e në mënyrë të veçantë mjaft nga mendimet e propozimet e Jani Vretos, po se në dorë të fundit ai u hartua nga Sami Frashëri që ishte tani një personalitet me autoritet të njohur në botën letrare turke, lozte një rol drejtues në lëvizjen kombëtare shqiptare e kishte një përgatitje shumë të mirë gjuhësore.

E dhëna se në komision ky alfabet u parashtrua nga Sami Frashëri, duhet të jetë e vërtetë. Kalendar Kombiar 1905 (f. 30-31) shkruan kështu: «Puna m'e madh'e Samiut është shkrimi shqip (;) më 1879 shoqërija q'u bë në Stamboll për të ngjallurë shqipenë, kish për shpirt dhe për kryesonjës Sami benë. N'atë shoqëri më parë u zgjodhë shkronjatë shqip. Nga këshillonjësit Jani Vretua thosh që të shkrojmë me shkronja greqisht, Vaso Pasha thosh të shkrojmë me shkronja fjeshtë latinisht, dhe, ata zëre që s'janë në këto shkronja, t'i bëjmë duke bashkuarë dy letra; Hoxha Tahsin thosh që të marrim një palë shkronja të veçanta, që të mos kenë ngjarje me asnjë nga alfabetet që dihenë; këto shkronja qenë si vija me cmagje. Po nga gjithë këto mendime i Samiut u pëlqye më tepërë i cili thosh të marrëm shkronjëzat latine, po të bëjmë dhe ca të tjera për ato zëre që ka nevojë gjuha jonë; Sami thosh... që të përzjerë dy shkronja për të bërë një zë është një rëndësi e madhe në të shkruar e në të hartuar; edhe më tepërë për gjuhënë shqip së cilës i duhenë kaqë shkronja që s'i ka latinishtja». Dhe në shënim: «Sami beu gdhendi vetë me dorë këto shkronja...». Mendimi i Vretos nuk është dhënë sakët në këtë dëshmi.

20) Sh. Kolonja, *vep. e cituar*, duke folur për të, thotë se autorët e tij «i vunë përpara syvet të gjitha shkronjat e librat që qenë bërë gjer atëhere për gjuhënë shqip dhe e panë që kishin të meta e s'ishin të lehta për shqipen, pra ishte nevojë që të ndryshoheshin, të gdhendeshin e të ndërtoheshin pas trupit të gjuhës shqip, edhe ashtu i bënë». Alfabeti i 1879 kishte mjaft shkronja greke, si $\delta = dh$, $\theta = th$,

bollit, me germat e përziera që kishte, paraqiste vështirësi shtypi, kërkonte shtypshkronja të posaçme. Kur nga fundi i shekullit numri i botimeve shqip zuri të shtohet e nisën të dilnin në vende të ndryshme të Evropës gazeta e revista shqipe, kushtet teknike, por mjaft herë edhe arësye të tjera, ku nuk mungonin të vepronin edhe tendencat politike, bënë që të përdorej gjithnjë e më tepër edhe një alfabet thjesht latin me digrame për të plotësuar germat e thjeshta. Të tilla alfabetë përdorën gazetat e Bukureshtit «Shqiptari» (1888) dhe «Shqipëria» (1897), revista «Albania» e Brukselit²¹ (1896) etj. Një sistem të tillë zgjodhi edhe shoqëria letrare klerikale e Shkodrës «Bashkimi» (1899), që krijoi një alfabet të ri²². Një sistem të ndryshëm, atë të plotësisht të gërmave latine me germa me shenja diakritike, sistem i ndjekur në shkallë të gjerë nga albanologët e huaj, pranoi shoqëria tjetër klerikale e Shkodrës «Agimi» (1901)²³ me alfabetin e përpunuar nga Ndre Mjeda.

Kështu në vitet e para të shekullit tonë, në shkrim të shqipes, përdorshin sisteme e alfabetë të ndryshme, me një numër të madh variantesh e nënvariantesh që sa vinte e shtoheshin. Për një pjesë të mirë të tingujve, alfabeti mori forma nga më të ndryshmet, me bashkime të ndryshme germash, me përdorime të ndryshme shkronjash diakritike me kombinime të ndryshme. Këtu ndikonin mjaft vllitë praktike, kushtet teknike, por edhe më shumë vështirimet e ndryshme, rivalitetet, herë-herë edhe egoizmat e trillet vetiake.

Prapa qëndrimeve të ndryshme në punë të alfabetit, divergjencave dhe rivaliteteve të ndryshme, qëndronin shpesh qëndrime të ndryshme politike, interesa të caktuara, kontradikta të ndryshme politike. Përpjekje sistematike bëjnë në këto vite imperializmi austro-hungar dhe ai italian për të ndikuar në zhvillimin e problemit të alfabetit, nëpërmjet të agjenturës dhe të forcave që bënin popllkën e tyre, në radhë të parë të klerit

$\lambda = ll, p = rr, \varepsilon = e, \sigma = sh$. Shënimi i disa tingujve bëhej me germa latine a greke të ndryshuara: *gj* me *g* të anasjelltë *ç, p* me *p* të pambyllur, *xh* me *x* të modifikuar *Y*. Edhe disa gervave latine ju dha një vlerë e veçantë *c = c, e = ë, x = x*. Për *ç* e *zh* u përdorën gërma me shenja diakritike: *ç, z*.

21) Gazeta «Shqipëtarë» e Nikoll Naços, përdori alfabetin latin në bazë të grafisë rumune. «Shqipëria» që në numrin e dytë arësyei përdorimin e alfabetit thjesht latin: «Një gjë del e fituar që të gjithë njohin se shenjat e zërevet të gjuhës duhet të kenë fytyra latine. Për zëret që dyshohen o që bashkohen me të tjerë, harrijnë ca pika dhe bashkimi i shenjave alfabetare latine e gjithkush munt t'i bashkojë si e kupëton më mirë». Duke u mbrojtur kundra kritikave të rënda e padive të shumë atdhetarëve për mospërdorimin e alfabetit të Stambollit, në nr. 6 (14.VI.1897) shpjegoi kështu: «Neve kur e muarmë këtë alfabet që shkruajmë e bëmë vetëm se e gjetëm më të lehtë dhe më të përdorur. Nuk i vumë re aq fytyrës së alfabetit duke e ditur se kjo ndryshohet, po ideja është e përjetshme». Dhe shton se «alfabetin kombiar të vërtetë do t'e bëjnë Akadhimia, kur të harriet puna, sikundër ka ngjarë dhe në të tjerë llauze». Ky alfabet pati mjaft digrame: *sh = sh, dh = dh, lh = ll, gh = gj, th = th, dj = xh, dz = x, disa germa me shenja diakritike: ë = ë, ñ = nj, ç = ç, î = j, e, k, z* u përdorën me vlerat e tyre të sotme. Revista «Albania» e Brukselit (1896-1908) përdori më gjerë digrame e shenja diakritike: *dh, th, gh = gj, sh, lh = ll, rh = rr, dz = x, ç = ç, é = e, ñ = nj, ž = zh, dz = xh*. Germa e tjera qenë germa të thjeshta latine me vlerat që kanë në alfabetin e sotëm me përjashtim të *e = ë*. Pati më pas disa ndryshime.

22) Kjo shoqëri, për plotësimin e gervave të nevojshme, përdori vetëm sistemin e digrameve: *dh, th, sh, xh = zh, zh = xh, ch = ç, gh = gj, ll, gn = nj, ts = c*. Germa *c* u përdor për *ç, é* për *e, x* për *z* e *z* për *x*. Në vlerat e dhëna disa gervave e në disa digrame shihet ndjekja e grafisë italiane.

23) Duke ndjekur parimin e një tingulli për një shkronjë e të një shkronje për një tingull, si alfabeti i Stambollit, germa e alfabetit latin i plotësoi me germa me shenja diakritike: *g' = gj, h' = q, ú = nj, đ = dh, p = th, t = ll, č = c, š = sh, ž = zh, ř = rr*. Pati edhe dy digrame: *dz = z, dž = zh*. Ka $\vartheta = e, é = e$.

katolik, dhe për të fituar, në saje të kësaj veprimtarie, pozita në lëvizjen kulturore e politike kombëtare shqiptare. Po në më se një rast variantet qenë edhe shprehje e dëshirave për të gjetur mjetet më adekuat për paraqitjen e tingujve të shqipes, ose e përpjekjeve për të afruar sistemet e alfabetet e ndryshme në rrugën e formimit të një alfabeti të përbashkët të vetëm. Vazhdimisht dilnin variante e nënvariate të reja, duke krijuar një babiloni të vërtetë, ku gjente shesh të lirë të vepronte edhe puna armiqësore e huaj. Ky kaos u nxirrte pengesa të mëdha përhapjes së botimeve shqipe e të arësimit në gjuhë shqipe, zhvillimit të letërsisë e të kulturës shqiptare. E gjithë kjo dëmtonte shumë luftën çlirimtare, se fjala e shkruar ishte një mjet i fuqishëm i propagandës kombëtare, i zgjimit kombëtar. Rolin e saj e ka përcaktuar më së miri shoku Enver duke folur për punën e madhe të rilindasve në lëmin kulturor. «Fjala e shkruar, — thotë ai, — do të ishte ai rrip transmissioni i rëndësishëm për tek masat, nëpër të cilin do të rridhnin si përrua idetë çlirimtare dhe zjarri i pashuar i njerëzve më të përparuar të kohës. Ajo do të shpërndante errësirën e do të mbillte diturinë, do të zgjonte e kalitëte ndjenjat kombëtare në zemrat e shqiptarëve, do t'i edukonte, do t'i lidhte e bashkonte më fort masat, do t'i hidhte ato në luftë për liri» (Nga fjala mbajtur në pritjen me rastin e 50-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, më 29 nëndor 1962). Njësimi i alfabetit ishte edhe një shfaqje e bashkimit kombëtar, e forcimit të unitetit të popullit në luftën e tij çlirimtare. Çështja ishte bërë kështu një problem i mprehtë politik, zgjidhja e saj një kërkesë e momentit historik.

Sa më shumë rritej lëvizja kombëtare, shtoheshhin botimet shqipe, dilte nevoja e realizimit dhe e zhvillimit të arësimit në gjuhë amatore, e përhapjes në masë të shkrimit e të leximit të shqipes, kjo plagë zuri të ndjehej gjithnjë e më shumë. Që në vitet e fundit të shekullit XIX, në shtyp shtrohet me forcë çështja e alfabetit. Zhvillohen diskutime rreth të metave e të mirave të sistemeve e të alfabetëve kryesore të përdorura, organizohen anketa, jepen mendime e propozime për alfabetin më të përshtatshëm, ngrihet kërkesa për afrim e njësim. Në këto diskutime merrnin pjesë publicistë e shkrimtarë të njohur, lëvrues gjuhe, mësues e patriotë të tjerë, lexues të thjeshtë. Për t'u përmendur janë diskutimet e viteve 1897-8, 1905, 1907, po çështja vijoi të rrihet vazhdimisht e të qëndrojë në qendër të vëmendjes së lëvizjes kulturore kombëtare²⁴. Mendimet ishin të ndara sidomos midis rrymës për alfabetin e Stambollit e asaj të përkrahësve të një alfabeti thjesht latin me digrame, alfabet që paraqiste variante të ndryshme, po që fitonte gjithnjë e më shumë terren, për arsye sidomos të volisë praktike. Bëhen orvatje të ndryshme për t'i pakësuar këto ndryshime variantesh e për të afruar këto dy sisteme alfabetesh. Hidhet dhe mendimi se duhej krijuar një alfabet i ri që të ishte më i mirë se alfabetet ekzistuese.

U bënë propozime, u muarën edhe inisiativa për të arritur në njëzi-

24) Shih diskutimin në revistën «Albania» të Brukselit I, 7, 10; II 6; IV 1, 4, 6; V 3; VI 1, 8; VIII 12; IX (1905), 2, 3, 6, 10, 12; X (1906) 4, 5, 6; etj.; në gaz. «Shqipëria» të Bukureshtit 1897-1899, nr. 2, 6, 7, 8, 9, 32, 37, 49-53, 54, 58; «Kombi» i Bostonit, 1906-8, nr. 2, 10, 30, 37-38, 39, 48, 64, 105. Po kështu u dhanë mendime edhe në gazetën e tjera si «La Nazione Albanese» e Katanzaros e Anselmo Lorechios I (1897) 6, III, 9, 23; VI 1, 10, 11; XI, 9 etj.; gazetën «Shqipëria» e «Pellazgu» të Kajros etj. Ndër pjesëmarrësit në këto diskutime qenë F. Konica, Visar Dodani, Shahin Kolonja, S. Peci, Luigj Gurakuqi, Çajupi, Asdreni, Aleksandër Xhuvani, Mati Logoreci etj.

min e dëshiruar të alfabetit²⁵. Në kontaktet midis rretheve patriotike dhe në shtyp u hodh edhe mendimi për të thirrur, në një qendër jashtë Shqipërisë, një mbledhje të përgjithshme, ku të përfaqësoheshin organet e shoqëritë e ndryshme, si edhe personalitetet më të shquara të jetës kulturore, për t'i dhënë fund gjendjes aq shumë të pakënaqshme që ekzistonte në shkrim të shqipes, duke u marrë vesh për një alfabet të vetëm kombëtar. Dhe në këtë drejtim u ndërmuarën edhe disa veprime në vitet 1906-8, po që, për arsye të ndryshme, s'arritën të shpiheshin gjer në fund e të realizohej mbledhja e dëshiruar. Qëndrim të papajtueshëm për afrim mbante veçanërisht kryetari i shoqërisë klerikale «Bashkimi», që mbahej aso kohe si përfaqësuese kryesore e rrymës së alfabetit thjesht latin, abati i Mirditës, Preng Doçi. Ky zgjidhjen e çështjes së alfabetit e shihte vetëm në pranimin e alfabetit ose të sistemit të shoqërisë së tij, nuk linte mjet pa përdorur për t'ja arritur këtij objektivit dhe për t'i siguruar, me anë të këtij, një rol drejtues klerit katolik në lëvizjen kulturore. Jo të gatshëm për koncesione për hir të bashkimit tregoheshin edhe disa rrethe përkrahëse të alfabetit të Stambollit.

Më 1906 bëhet fjalë për një kongres që do të mbledhej në Vjenë, më 1907, për një kongres për t'u mbledhur në Bukuresht, më 1908 për një Kongres në Svicër²⁶. Kërkesat për bashkim nga rrethet patriotike bëheshin gjithnjë e më këmbëngulëse. Në fillim të vitit 1907 shoqëria letrare-arsimore «Mbarësia» e krijuar në një qytet të Shqipërisë, në një thirrje që botonte²⁷, ku lajmëronte se kishte gati një sërë librash mësimore shqip, po priste që të merrte rrugë puna e alfabetit, i ftonte të gjithë për një diskutim përfundimtar të çështjes në shtyp e për zgjidhjen e saj brenda disa muajve. Fan Noli bëhej shprehës i ndjenjave të masave patriotike duke thënë: «Një abece për të gjithë shqiptarët dhe si të dojë le të jetë.

25) Gazeta «Shqipëria» e Bukureshtit që më 1897 kërkonte mbledhjen e një komisioni me njerëz kompetentë nga shqiptarë e të huaj që merren me shqipen për t'i dhënë zgjidhje njësimtë të alfabetit.

Kongresi gjuhësor I i arbëreshëve të Italisë (1-3 tetor 1895) ngrinte nevojën e njësimtë të alfabetit dhe vendoste si hap të parë njësimin e shkrimit të botimeve arbëreshe në bazë të alfabetit që përdorte që nga viti 1894 poeti Jeronim De Rada. Kishte tri germa greke $\delta = dh$, $\theta = th$, $\xi = z$; një numër digramesh si: $rh = rr$, $gh = g$, $gj = gj$, $sg = zh$; ndonjë germë me shënja diakritike si e $\xi = sh$.

26) Në Albania IX (1905) 10 P. Llambi propozon të bëhet një mbledhje e përgjithshme për alfabetin në Trieste, Bukuresht a ku të dojë shumica. Qëndrimi i drejtorit të revistës është kundër: «të mos humbim kohën me kongrese».

Letër e P. Evangjelit rumanisht drejtuar Kr. Dakos, 24.VI.1906 (Arkivi qendror, shtetëror i RPSH i cili më tejje do të citohet AQSh i RPSH. Fondi Th. Gërmenji): «Në Kongresin e Vienës ku do të diskutohet çështja e alfabetit jam i mendimit që të dërgojmë edhe ne një përfaqësues».

«Kombi» II (1907) 33 jep lajmin se sipas informatave që i kanë ardhur nga Shqipëria e gjetkë, së shpejti do të mbahet në Bukuresht një kongres ku do të përfaqësohen të gjitha shoqëritë shqiptare për të vendosur përfundimisht çështjen e alfabetit të shqipes. Në nr. 39 po aty thuhet se shoqëria «Bashkimi» e Bukureshtit po përpikët t'i japë fund çështjes së alfabetit, është ngritur edhe një komision. Në nr. 64 (6.XII.1907) flet për përpjekjet e disa shqiptarëve për të organizuar një kongres shqiptar për të zgjidhur çështjen e alfabetit; kongresi do të mbahej në Svicër dhe do të thirreshin të merrnin pjesë letrarët më të njohur dhe shoqëritë.

27) «Kombi», II, nr. 30, 20.III.1907: «Ene si të shoshet e të përshoshet mirë e mirë kjo punë, atëhere me një mend të gjithë të pëlqejmë e të vemë në përdorje të përqipartshme një abetare e cila të jetë e ardhme për gjuhën shqipe». Shpallja, pas zgjidhjes së çështjes së alfabetit, shtron nevojën e zgjidhjes së gjuhës së njësuar letrare: «Si të marëshehet kjo punë, atëhere prap po me të punumun së bashkë mund të përpikemi për të kriju një ligjërojë shqipe të përgjithëshme dyke rrjeshtu fjalorin e shkrojtoren e saj». Në letrën shoqëruese drejtuar gazetës.

Kjo është thirrja e tërë shqipëtarëve. Mjaft... abecera se është turp» (Kombi I, 5, 29.VI.1906). Bëhen, më 1908, disa marrëveshje të pjeshme midis grupesh të ndryshme e midis disa organeve kryesore të shtypit²⁸. Në mars 1908 edhe shoqëria e shqiptarëve të Egjiptit merr iniciativën e një konsultimi midis organizatave kombëtare «që të bashkohen shkronjat shqiptare me një abece kungare dhe përgjithëse».

Më 23 korrik 1908, në pasojë të luftës së masave popullore të popujve të shtypur, si edhe të lëvizjes së turqve të rinj kundër regjimit autokratik dhe tiranisë së sulltan Hamidit, në Perandorinë osmane u shpall Kushtetuta. U bënë premtime të bujshme për vendosjen e lirive politike, për njohjen e barazisë dhe të drejtave të gjithë kombësive të Perandorisë. Populli shqiptar, që kishte vuajtur më shumë nga të gjithë, që s'kishte qenë njohur nga qeveria osmane zyrtarisht si komb i veçantë e të cilit i kishin qenë mohuar edhe të drejtat më elementare, shpejtoi të shfrytëzonte situatën e krijuar për të realizuar vetëm kërkesat e tij kulturore kombëtae e disa të drejta themelore politike. Patriotët shqiptarë, para se të merrnin ndonjë qëndrim turqit e rinj ose xhonturqit, siç u quajtën, me një shpejtësi të madhe ngritën klube e shoqëri, hapën shkolla e kurse për të mësuar shkrimin e leximin e shqipes, nisën të nxjerrin gazeta e të zhvillojnë një agjitacion të gjerë për përhapjen e ideve kombëtare në popull. Që në ditët e para të gushtit çelen shkolla shqipe në Elbasan, Vlorë, Korçë, Berat, Tiranë e kështu edhe në qytetet e tjera. Menjëherë pas shpalljes së Kushtetutës themelohet klubi «Bashkimi» i Manastirit, i ndjekur nga klubet e Selanikut, Stambollit, Elbasanit, Korçës, Beratit, Vlorës, Janinës, Pogradecit etj. Gjer në fund të vitit ishin ngritur në Shqipëri e në qendra të tjera të Perandorisë osmane, ku kishte shqiptarë, 24 klube e 6 shoqëri, numër që erdhi duke u shtuar. Lëvizja kombëtare mori një karakter gjithnjë e më masiv, zuri të shtrihet në masa të gjera, të depërtojë në ambiente të ndryshme dhe të ecë me vrull përpara. Në gji të saj nisën të përvijohen tendenca e rryma të ndryshme, shprehëse të interesave të ndryshme klasore, me qëndrime të ndryshme ndaj detyrave historike që shtroheshin, të strategjisë e të taktikës që duhej ndjekur. Dalloheshin ndër to një rrymë më radikale, e përfaqësuar nga elementë borgjezë e mikroborgjezë me tendenca demokratike, që ishte e mendimit se duhej vepruar për çlirimin e Shqipërisë nga robëria turke edhe me kryengritje të armatosur, dhe një rrymë reformiste e përfaqësua kryesisht nga çifligarë e funksionarë liberalë, që kërkonte vetëm fitimin e të drejtave kulturore dhe të një farë autonomie administrative. Zhvillimi i lëvizjes kombëtare detyroi t'i afrohen asaj edhe bashkëudhëtarë të përkohshëm, çifligarë e bor-

28) Një letër e Nuçi Naçit e 8.III.1907 nga Shkodra, ku ndodhet prej dy muajsh, drejtuar shoqërisë «Bashkimi» të Bukureshtit, flet për një marrëveshje të pjeshme të arritur atje për punë të alfabetit, dhe jep projektin e një alfabeti që synon të bashkojë tri alfabetet kryesore ekzistuese duke kërkuar të jepet mendimi për të. Ky ndryshon vetëm në 6 germa nga alfabeti i sotëm ç = ç, ğ = gj, ñ = nj, š = sh, ž = zh, ž = xh (AQSH. i RPSH, Fondi i Kolonisë së Bukureshtit, Dosja 77, Dokum. 480).

«Kombi», III nr. 105, 16.X.1908, flet për një ujdj në mes gazetave «Kombi», «Drita e Sofjes dhe «Dashamiri» në fillim të vitit për përdorimin prej tyre të një alfabeti të njëjtë.

Edhe pak muaj para Kongresit flitet për një marrëveshje të pjeshme paraprake midis anëtarësh të alfabeteve të Agimit e të Stambollit (Raport i konsullit austro-hungar të Manastirit 31.VIII.1908, Hans-Hof-und-Staatsarchiv — Politiches Archiv-Albanien, Arkivi i Vienës, i cili më tutje do të citohet me shkurtimet H. H. St. A, P. A, A.

gjezë konservatorë, klerikë, funksionarë qeveritarë, me qëllim që të vihen në krye për të ruajtur pozitat e tyre, për ta drejtuar lëvizjen në rrugën e interesave të tyre dhe të fuqive të cilave u shërbenin. Shumë prej tyre zunë edhe pozita drejtuese në mjaft klube. Ata bashkë me elementët oportunistë frenonin shumë lëvizjen kombëtare, pengonin luftën çlirimtare.

Me mundësitë që fitoi lëvizja kulturore kombëtare, me detyrat që shtroheshin për zhvillimin e një veprimtarie të gjerë e të organizuar për zgjimin kombëtar, duke hapur shkolla në gjuhë amtare, duke përhapur në masat e gjera shkrimin e leximin e shqipes, duke shtuar organet e shtypit e botimet e ndryshme, çështjet e lidhura me fjalën e shkruar shqipe merrnin një rëndësi të veçantë. Përpara të gjithave dilte nevoja e zgjidhjes sa më parë të çështjes së alfabetit. Nevoja e një alfabeti të përbashkët ndjehej prej të gjithëve. Nga çdo anë kërkohej bashkimi. Mendimi i organizimit të një mbledhjeje të përgjithshme për të biseduar mbi këtë çështje e për t'i dhënë fund një herë e mirë asaj zjente, si thamë, prej disa vitesh. Menjëherë pas Kushtetutës, nisën përsëri kërkesa²⁹ dhe konsultime midis rretheve atdhetare për thirrjen e një mbledhjeje të tillë. Po inisiativën konkrete e mori klubi «Bashkimi» i Manastirit. Ky, që në mbledhjen e parë të tij më 23 gusht, vendosi të thirret një kongres që, si thotë ftesa e shpërndarë në shtator, «t'i japim një mbarim kësaj së madheje nevojë për bashkim të gjithë shqiptarëve me një abe».

Zgjidhja e çështjes së alfabetit, ishte qëllimi kryesor për të cilin thirrej Kongresi, po jo i vetmi. «Lëvizja kombëtare që kishte shpërthyer si një vullkan, në një mënyrë të vetvetishme, pa lidhje ose me lidhje të dobëta a të rastit një vend me tjetrin, kishte nevojë të orientohej drejt synimesh të përbashkëta, drejt një programi të përbashkët, të merrte forma organizative që t'i lejonin të mbronte sa më mirë e më me efekt të drejtat kombëtare. Prandaj në program të Kongresit qenë përfshirë edhe çështje të tjera të natyrës kulturore-politike dhe politike.

Kongresi u hap më 14 nëndor. Erdhën 50 delegatë, po, sipas vendimit për të mos pasur një klub a shoqëri më shumë se dy të dërguar, u njoh e drejta e pjesëmarrjes efektive me votë vetëm 32 vetëve, përfaqësues të 23 klubeve, shoqërive e qyteteve. Merrnin pjesë drejtorë gazetash e letrarë, lëvrues të gjuhës e mësues të shqipes, militantë të njohur të lëvizjes politike kombëtare, po edhe të tjerë të dërguar. Ndoreshin ndërmjet tyre: Shahin Kolonja, Bajo Topulli, Mihal Grameno, Luigj Gurakuqi, Sotir Peçi, Hil Mosi, Ndre Mjeda, Gjergj Qiriaz, Mati Logoreci, Thoma Avrami, Simon Shuteriqi, Grigor Cilka etj. Ishte mbledhja e përgjithshme kombëtare e parë pas Lidhjes së Prizrenit, i pari kongres shqiptar relativisht përfaqësues, në të cilin merrnin pjesë shqiptarë, pa dallim feje e krahine, të anëve më të ndryshme të vendit, duke u përfaqësuar shumica e madhe e trevave shqiptare dhe kolonitë shqiptare kryesore.

29) Gazeta «Kombi» e Bostonit më 28.VIII.1908 (nr. 99) në artikullin «Shkollat shqip» shkruante ndër të tjera: «I pari shkëmp që duhet kapërxyer është i shkronjavet. Kemi shkrojtur dhe thirrur aqë sa nukë na mbetet më fuqi të përsëritim ato që kemi thënë përmi nevojën e zgjidhjes të një alfabeti kombëtar». Edhe gazeta «Drita» e Sofjes në një artikull të datës 12.IX.1908 «Konstitucia dhe detyrat e shqipëtarëve» (nga Plaku i Nemërçkës, nr. 101) në një plan punësh e kërkesash që shtronte, në krye vinte këtë: «Të mblidhenë ndë një mbledhje mbë ndonjë qytet të Shqipërisë gjithë ata që kanë punuarë gjer sot për të shkruarët e gjuhësë e të vendosinë një program të përgjithshëm e vetëm një alfabet të përdorin gjithë ata që shkruajnë libra e nxjerënë gazeta».

Punimet e Kongresit zgjatën nëntë ditë³⁰. Mbledhjet plenare, që qenë të hapta për gjithë shqiptarët, — një pjesë edhe për dëgjues të tjerë, — duke qenë të pranishëm rreth 400 vetë, u kthyen më se njëherë në mitingje, në manifestime të zjarra patriotike, ku u shprehën me forcë bashkimi dhe nevoja e përforcimit të unitetit të popullit shqiptar, aspirata për të dalë sa më parë nga prapambetja e për të ecur me ritme të shpejta në rrugën e përparimit, vendosmëria për të gëzuar të drejtat kombëtare. Në to u shprehën mendime edhe për alfabetin që duhej të bëhej alfabeti kombëtar i vetëm i shqiptarëve³¹. Të gjithë i mbaruan fjalimet duke treguar se duheshin flijuar interesat e veçanta për të sjellë unitetin përmes alfabetit.

Kongresi zgjodhi nga gjiri i tij një komision prej 11 vetësh, të cilit i dha fuqi të plota për të caktuar alfabetin e përbashkët kombëtar, duke u betuar delegatët se do të pranojnë ç'të vendosë ai. Komisioni, ku përfaqësoheshin tri alfabetet kryesore ekzistuese, punoi intesivisht për tri ditë rresht në një seri seancash të mbyllura³². Gjithë puna që ishte zhvilluar në shtyp e gjetiu në priudhën para Kongresit, kish të arritur një seri përfundimesh, kishte sqaruar çështje të pjesshme e kishte sjellë ndonjë afrim midis pikëpamjeve të ndryshme, kishte përgatitur terrenin — po gjer në një farë mase — për zgjidhjen përfundimtare, po nuk kishte mënjanuar ende gjithë faktorët negativë e gjithë pengesat që dilnin. Mungesa e një pune përgatitore të mirëfilltë, e kontakteve paraprake ndërmjet përfaqësuesve të sistemeve kryesore, e bisedimeve që të kishin sheshuar divergjencat e të kishin arritur në marrëveshje, të paktën në vijat e përgjithshme, e vështirësuan shumë punën.

Që në krye u vendos që alfabeti i shqipes do të ishte alfabet latin. Puna qëndronte në caktimin e vlerave që do të kishin gerrat latine në alfabetin shqip, — pse për një pjesë të tyre kishte ndryshime në mes të alfabetve ekzistuese, — e sidomos në caktimin e sistemit dhe të she-

30) Një kronikë relativisht e hollësishme e Kongresit për seancat e përgjithshme e për manifestimet lidhur me të u dha në gazetën «Lirija» (I, nr. 15, 8/21.X.1908). Një përmbledhje e punimeve jepet në një raport të konsullatës austro-hungare të Manastirit të datës 23.XI.1908 (H.H.St. A. P. A. A.), dhe më gjerë në një relacion prej 20 f. të 20 janarit 1909 të Gjergj Qiriazi që qe nënkryetar i Kongresit (po aty). Në Arkivin e Shtetit të Republikës Popullore të Shqipërisë ekzistojnë shënime të karakterit të procesverbalit për mbledhjen e datës 20.XI.1908 (2f.) dhe për mbledhjen e fundit të datës 22.XI (4 f.).

31) Për lehtësinë e alfabetit të Stambollit, shërbimet që ka bërë dhe përhapjen e madhe që ka në Shqipëri, folën M. Grameno, Gr. Cilka, F. Ypi; kurse Ndre Mjeda për afërsinë e alfabeve të Agimit e të Stambollit, meqenëse të dy kanë një shkronjë të vetme për një tingull. H. Mosi, ditën e dytë, propozoi të bëhet një alfabet i ri duke bashkuar tri alfabetet kryesore që ishin në përdorim: të Stambollit, të Agimit, të Bashkimit. L. Gurakuqi tha se do të ishte më mirë, për të mos i thyer zemrën askujt, të përpunohet një alfabet i ri në bazë të kërkesave shkencore, duke pasur parasysh gjuhën shqipe, dialektet e gramatikën e saj. Ai tregoi se tingulli i shënuar me alfabetin e sotëm me *gj*, është një ndryshim i *gl* dhe *g-j*, një bashkim i *n* me *j*, *q* një bashkim i *k* dhe *j*.

32) Anëtarët e tij dhanë besën se do të mbanin fshehtësinë për bisedimet që do të bënin dhe se s'do të nxirrnin jashtë komisionit asnjë fjalë para zgjidhjes së çështjes së alfabetit. Për mbledhjet e komisionit s'u botua asgjë, as në atë kohë, as më vonë. Një numër të dhënash me interes për to i gjejmë në relacionin e sipërpërmendur të Gjergj Qiriazi, po jo një parashtrim të hollësishëm të pikëpamjeve e të argumentave që u parashtruan. Aty del se është mbajtur një procesverbal i rregullt. Në AQSh. të RPSH. (Fondi Th. Germenji, nr. 5) ka disa shënime për mbledhjen V e mbledhjen VI të Komisionit, të datës 18.XI.1908. A janë pjesë të procesverbalit origjinal, kopje të tij, a shënime të një anëtarit të komisionit? Nuk mund të thuhet diçka e sigurtë. Alfabeti i përdorur bazohet në atë të Stambollit, dialekti është gegërisht. Mund të jenë shkruar nga L. Gurakuqi. Ka ndonjë mospërkim me të dhënat e Gj. Qiriazi.

njave konkrete që do të përdorehin për tingujt e shqipes që s'i ka latinishtja. Dilnin tri mundësi: 1) të merrej njëri nga tre alfabetet kryesore që përdorehin, me ose pa ndonjë ndryshim; 2) të formohej një alfabet me elemente të tri sistemeve, duke i shkruirë tri alfabetet në një; 3) të krijohesh një alfabet i ri, pa marrë parasysh tri alfabetet kryesore ekzistuese.

Zgjidhja e parë u mënjanua për arsënyen se asnjë prej tri alfabeteve s'ishte pa të meta e pa anë të dobëta e se ajo zgjidhje do të ngjallte pakënaqësi ndër përkrahësit e alfabeteve të tjera. Komisioni vendosi të krijojë një alfabet të ri duke i marrë një për një tingujt e shqipes për të caktuar, mbi kritere të drejta shkencore e në përshtatje sa më të saktë me gjuhën shqipe, gërmat dhe mënyrat si do të shënoheshin ato³³. Për përcaktimin e vlerave që do të kishin gërmat e thjeshta, nuk dilnin vështirësi të mëdha. Po diskutime të zjarrta ngjallën tingujt e shqipes, për të cilët s'kishte gërma të thjeshta latine. U deshën dy seanca për ndërthemboren e zëshme dh³⁴. Po së fundi komisioni, duke parë vështirësitë që po dilnin, divergjencat e forta që ekzistonin, hoqi dorë, — nuk e dimë në çfarë rrethanash — nga caktimi i një alfabeti të vetëm dhe vendosi për dy alfabete³⁵. Një nga anëtarët e komisionit, Gjergj Qiriazi, në një relacion të asaj kohe e përligj zgjedhjen e dy alfabeteve me përkrahësit e fortë që kishin alfabeti i Stambollit dhe alfabeti latin me digrame si edhe përdorimin që kishin gjetur ata përkatësisht në zona të ndryshme të Shqipërisë³⁶.

33) Relacioni i Gj. Qiriazit f. 11: «Gjithë shkronjat e alfabetit latin u shqyrtuan me kujdes dhe u pranuan me disa ndryshime duke u dhënë atyre një tingull të ndryshëm. Shkronjat *ð, f, lj, η, σ, ð, (dh, gj, ll, nj, sh, th)* i shkaktuan komisionit shumë vështirësi.

34) Gjergj Qiriazi shënon se dy seanca ju kushtuan vetëm gërmës *dh* dhe prapë komisioni nuk arriti dot në një përfundim të kënaqshëm.

Shënimet që na kanë arritur për dy mbledhjet e ditës së dytë të punimeve të komisionit, të cilat i përmendëm më sipër, nuk përputhen plotësisht me këtë thënjë. Për mbledhjen e pestë shkruhet: «Pyetja e parë u nis me zanin *ð, ð, ð, ð*, dhe mbas shumë diskutimeve nuk u dha asnjë fund». Për të gjashtë: «U vendos si të shkruhet zani *ð* e ju vue fund qi të mirret me një *d*, të preme si e ka Agimi. Për tregim *ðe*».

35) Në shënimet e mbledhjes së gjashtë të sipërpërmendur tregohet se në këtë mbledhje u zgjidh edhe çështja e disa shkronjave të tjera, e *e-së, gj-së, q-së, nj-së*. Për *gj-në* u caktua digrami i sotshëm. «Mbas arsënyave të dhanuna për zanin *gj* pvetet që t'i epet fund dhe zaneve *q* e *η*». Pra u caktuan digramet *kj* e *nj*.

Gjergj Qiriazi referon ndryshe: «Duke marrë para sysh kohën kushtuar vetëm një shkronje, mund të shihnim fare lehtë se ç'vështirësi do të përballonim për shkronjat e tjera, d.m.th. për *f, η, σ, ð*, prandaj u propozua dhe u pranua të adaptohej alfabeti i Stambollit me pak ndryshime, dhe një i dytë, i cili do t'ish i tëri latinisht me njëzet e pesë shkronja dhe për pjesën tjetër.

Ky propozim u pranua prej gjithë anëtarëve të komitetit.

Se të relacioni i Gj. Qiriazit nuk kemi një parashtrim plotësisht të saktë, e shohim edhe në ndarjen e anëtarëve të komisionit në anëtarë të alfabetit të Stambollit e në anëtarë të alfabetit të «Bashkimit». Ai shënon në kategorinë e parë edhe Ndre Mjedën, çka i përgjigjet së vërtetës, por në kategorinë e dytë, në mënyrë të gabuar, edhe Grigor Cilkën që në mbledhjen plenare kishte mbrojtur alfabetin e Stambollit e vështirë të kishte ndrruar mendim brenda 3-4 ditëve.

36) Gjergj Qiriazi në relacionin e tij është përpjekur t'i përgjigjet pyetjes «Përse u zgjodhën dy alfabete?» dhe të përligjë vendimin e Kongresit, dhe të japë arsënyet e tij: «Telegramet e ardhura nga Gegëria na luteshin të merrnim alfabetin e Bashkimit dhe telegramet e ardhura nga Toskëria na luteshin të përdornim atë të Stambollit ose të ashtuquajtur të Frashërit. Komiteti [Komisioni] duhej të mirrte parasysh gjithë këto letra dhe telegrame, sepse, po të mos përfillnim njërën ose tjetrën anë, do të shkaktohej pengesë e madhe në përparimin e kombit. Dhe mbasi këto qenë përdorur

Në vendimin e komisionit të 20 nëndorit thuhet: «Pas që u kënduan verbalet e ditëve tjera e pas që e pamë që puna që kishim bërë ishte mjaft e madhe, po jo aqë sa të na kënaqte të gjithëve e t'i shërbente si përparimit të gjuhës, si të përhapurit të diturisë ndër ne, të shtyrë edhe nga disa shkake të përjashtme, u kthyem prapa e, me pëlqim të gjithëve, u vendos të mirret abeja e Stambollit e me të bashkë edhe një abe thjesht latine, që të mësohen e të përdoren bashkarisht në mes të shqiptarëve»³⁷.

Ka mundësi që në vendimet të ketë ndikuar edhe konsiderata e inkonvencioneve të mëdha që do të kishte ndryshimi i menjëhershëm i alfabetit, shkëputja e madhe nga praktika ekzistuese, për një fazë kalimtare, në një kohë kur shtrohej me ngutësi detyra e një përhapjeje të vullshme të botimeve shqipe, të shkrimit e leximit të gjuhës sonë. Alfabeti i Stambollit kishte marrë një përdorim mjaft të gjerë në Shqipëri. Nga ndonjë dëshmi del se në mendjen e anëtarëve të komisionit, zgjidhja e dhënë ishte për një periudhë kalimtare, gjatë së cilës praktika do të tregonte se cili nga dy alfabetet do të merrte sipërinë e duhej caktuar si alfabet i vetëm. Kongresi vendosi që të mblidhej pas dy vjetsh në Janinë një kongres tjetër për të biseduar mbi çështje të drejtshkrimit, të gjuhës e të letërsisë. Gjergj Qiriazi në relacionin e sipërpërmendur thotë: «Brenda këtyre dy vjetve përpara se të mblidhet kongresi tjetër, do të kuptohet se cili (prej këtyre dy alfabeteve) do të përdoret më shumë, dhe ky do të adoptohet si alfabet (i vetëm) kombëtar»³⁸.

në shkolla, njëri në Gegëri, tjetri në Toskëri, ne vendosëm me vota të plotë, të adaptojmë dy alfabetet, atë të Bashkimit dhe atë të Frashërit, me disa ndryshime, sipas nevojës së gjuhës». Këto shpjegime nuk janë bindëse e nuk sqarojnë plotësisht. Arësyt e sjella — me pasaktësi në kundërvënjen e përhapjes krahinore të dy alfabeteve — ekzistonin që në fillim e nuk qenë ndonjë fakt i ri që doli gjatë Kongresit. Mbetet gjithnjë pyetja: Pse nuk vijoi komisioni në punën që nisi, me pëlqim të njëzëshëm, për hartimin e një alfabeti të vetëm, po u kthye mbrapa, si e pohan edhe vetë në vendim?

37) Nga formulimi i sipërm del se s'ishin të gjithë të kënaqur nga puna që ishte bërë në dy ditët e para dhe se zgjidhjet e adoptuara kishin kundërshtarë në gjë të komisionit. Një rol veçanërisht negativ del të ketë lozur Midhat Frashëri me qëndrimin e tij të papajtueshëm ndaj çdo afrimi, duke u përpjekur, i udhëhequr nga interesa vetiake egoizmi e prestigji të sëmurë, të imponojë me çdo mënyrë alfabetin e Stambollit. Ai s'hoqi dorë nga manevrat e tij edhe pas vendimit të Kongresit.

Cilat qenë këto «shkaqe të përjashtme» që e shtynë komisionin të kthehet prapë e të caktojë dy alfabetet? Mos qenë shenjat shqetësuese të fushatës së afërt të agjenturës xhonturke për të imponuar alfabetin arabo-turk dhe konsiderata për të mos marrë një vendim që do të linte të pakënaqur në një moment kur nevojitej një bashkim sa më i madh e i gjerë kundër këtyre sulmeve? Që në tetor shkruhej në shtypin shqip: «Dëgjojmë se disa njerëz kërkojnë të na prishin alfabetin, duan të lemë shkronjat që kemi e të marrim të tjera, tyrqisht, greqisht, horvatisht. Ca kohë u pandeh se edhe Komiteti «Bashkim e Mbrothësi» nuk e sheh me sy të mirë këndimin e gjuhës shqip dhe përpiqet që të ndërrojë shkronjat e shqiptarëve...». Gazeta «Besa» e Stambollit që në numrin e parë, 18.XI.1908, shkruante se u provua që shqipja nuk shkruhet dot me germa turke. Në dhjetor 1908 qarkullonin në Stamboll fletë shkruar turqisht, ku thuhet se, për të qenë të gjithë osmanllinjta të bashkuar, duhej të shkruhej shqipja me shkronja turqisht.

38) Gj. Qiriazi në relacionin e tij thotë më se një herë se mendohej që të mbetej vetëm një alfabet: «... të dy alfabetet u pranuan si alfabet kombëtar dhe u vendos që gjithë shkollat të detyrohen t'i mësojnë që të dyja dhe cilido shkrimtar të përdorë atë që të pëlqejë më shumë dhe me shpresë që një ditë njeri alfabet do të mbetet».

Një telegram konfidencial i konsullatës austro-hungare të Manastirit i 21.XI.1908 lajmëronte Vienën kështu: «Një komision prej 11 vetash i Kongresit shqiptar, në mënyrë paraprake ka vendosur për dy alfabetet: ndërsa ka adoptuar si definitiv një alfabet latin..., për një periudhë kalimtare ka mbajtur alfabetin frashëriot të

Komisioni pati kujdes që t'i afrojë dy alfabetet e pranuar. Ai i bëri pesë ndryshime alfabetit të Stambollit, e pikërisht: u ndërkyembyen vlerat e *e* dhe *ε*, duke u përdorur e para për *e* dhe e dyta për *ε*; u hoq germa greke π dhe u vu në vend të saj germa latine *P*, *p*, duke mos pasur më kjo vlerën e *rr*; rrotullorja e fortë u vendos të jipej me *rr*; në vend të x_z do të përdorej χ (=xh). Në alfabetin thjesht latin u pranuan 6 germa latine me vlerat që kishin në alfabetin e Stambollit: *c*, *ç*, *j*, *q*, *y*, *x*. Dy alfabetet ndryshonin kështu vetëm në 9 germa (*dh/δ*, *ë/ε*, *gj/γ*. *ll/lj*, *nj/η*. *sh|σ*, *h/θ*, *zh/z*, *xh/χ*), ndërsa 27 germa i kishin të njëjta.

Ngjarjet që pasuan, lufta e ashpër që u ndez, pa shkuar një kohë e gjatë, për mbrojtjen e alfabetit kombëtar e të arësimit në gjuhë amtare kundër orvatjeve të xhonturqve për t'u imponuar shqiptarëve alfabetin arabo-turk dhe kundër masave shtypëse të qeverisë osmane për të penguar e mbytur lëvizjen kombëtare shqiptare, nuk dhanë mundësi që të mbahej kongresi i projektuar, as të rimerrej në një mënyrë tjetër çështja e alfabetit për të realizuar njëzimin e plotë. Po vetë jeta e zgjidhi përfundimisht problemin, pa pasur nevojë për mbledhje, komisione e vendime, duke lënë në përdorim një alfabet të vetëm. Alfabeti latin i papërzjerë, i përpunuar nga Kongresi, kishte të mirën se ishte homogjen për nga karakteri i germave, i lehtë në të shkruar dhe mjaft i volitshëm në shtyp, se nuk kërkonte shtypëshkronja me germa të posaçme, prandaj mund të bëheshin botime me të në çdo vend. Kjo qe arësyeja kryesore që më pas, sidomos pas vitit 1912, alfabeti i Stambollit mbeti në një përdorim gjithnjë e më të kufizuar. Nga fundi i Luftës së parë botërore, alfabeti thjesht latin i Kongresit të Manastirit ishte bërë alfabeti i përbashkët i gjithë shqiptarëve, alfabeti i vetëm i shqipes. Është alfabet i sotëm i gjuhës sonë.

Vendimet e Kongresit të Manastirit ishin një fitore e shënuar e lëvizjes kombëtare shqiptare. Ato i dhanë fund kaosit që ishte krijuar në punë të alfabetit. Vërtet nuk u arrit në rezultatin e dëshiruar e të pritur, në caktimin e një alfabeti të vetëm, po eliminimi i mundësive për të nxjerrë alfabete e variante të reja, lënja në përdorim e vetëm dy alfabeteve — edhe ato mjaft të afërta midis tyre, — në vend të shtatë a tetë alfabeteve e të sa e sa varianteve e nënvarienteve, ishin përfundime me rëndësi për zhvillimin e gjuhës letrare shqipe, për arësimin dhe për letërsinë shqipe, kontribut efektiv në bashkimin e popullit shqiptar. Ato vendime, nëse nuk realizonin njëzimin e plotë të alfabetit, e bënë në mundshëm në një të ardhme jo të largët. Ja përse ato u pritën me kënaqësi e gëzim në botën shqiptare dhe u vunë në zbatim. Po edhe shkencëtarë

Konstantinopojës». (H. H. St. A. P. A.). Një telegram i konsullit austro-hungar të Shkodrës Kral i 22.XI.1908 e jep kështu vendimin: «Me gëzim të madh lajmëroj se Kongresi i alfabetit në Manastir, sipas telegramit të delegatëve të këtushëm ka vendosur një alfabet të përbashkët shqip krejtësisht me shkronja latine...». Po ai më 23.XI. telegrafonte: «Disa telegrame nga Manastiri flasin se alfabeti i Frashërit do të mbahet njëkohësisht si alfabet, kështu që u krijua dyshimi në se u zgjodhën një apo dy alfabete. Priten lajme të mëtejshme».

Megjithëse u vendos që të përdroreshin njëkohësisht të dy alfabetet, në Kongres theksi u vu më tepër në atë të Stambollit e jo, si mund të pritej, në alfabetin e ri të përpunuar nga Komisioni. Relatori i vendimit në mbledhjen plenare tha se alfabeti i Stambollit është i mjaftë për nevojat e kombit, po, me qenë se shumë herë, për të shtypur libra larg Shqipërisë dhe për të hequr telegraf, kemi nevojë për një alfabet thjesht latin, komisioni u shtrëngua të marrë dy alfabete, siç ndodh edhe te gjermanët, të cilët kanë alfabetin gotik dhe një alfabet latin.

të huaj, miq të Shqipërisë, si albanologu i shquar Holger Pedersen, me gjithë vërejtjet që thonin se mund t'u bëheshin disa zgjidhjeve të veçanta që ishin dhënë, si tërësi i vështruan vendimet e Kongresit të Manastirit si mjaft pozitive, si një sukses, si një përparim shumë i madh, për të cilën duhej urrear populli shqiptar. Mori qëndrim të hapur kundër tyre vetëm ndonjë emirëzi e njeri negativ si Faik Konica, i cili ndërmoi një fushatë të ashpër kundër Kongresit e punës së tij.

Shumë është folur për alfabetin e papërzjerë latin që përpunoi Kongresi i Manastirit e që u bë alfabeti kombëtar i shqipes; për përbërjen, burimet e autorët e tij, janë ndezur polemika, janë krijuar në të kaluarën edhe opinione të rreme e të pasakta që mund të ekzistojnë aty-këtu edhe sot. Një veprimtari sistematike ka zhvilluar kleri katolik për t'ja dhënë vetes, në kundërshtim me të vërtetën, meritat e krijimit të alfabetit të sotëm. Ka qenë shumë i përhapur mendimi — dhe që në kohën e Kongresit³⁹ — se alfabeti thjesht latin i vendosur atje, s'që veçse alfabeti i shoqërisë klerikale «Bashkimi» të Shkodrës ose alfabeti i «Bashkimit» me disa ndryshime. Ky mendim e ka pasur në një pjesë të mirë burimin në identifikimin e gabuar të alfabetit thjesht latin me digrame me atë të kësaj shoqërie. Alfabeti i «Bashkimit» ishte një nga variantet e këtij alfabeti, po as i pari, as më i përhapuri. Para tij përdorën këtë alfabet për shqipen Zef Jubani, Dhimitër Kamarda, Pashko Vasa, «Shqipëtari» i Nikoll Naços, «Shqipëria» e Bukureshtit, «Albania» e Brukselit e të tjera botime. Në të njëjtën kohë, të njëjtin sistem, më të shumtën pa lidhje me të, e përdorin një numër i madh organesh shqipe të mërgimit e autorë të ndryshëm dhe disa prej ktyre ishin botime që binin në dorë të një numri më të madh lexuesish, me jehonë më të madhe se botimet e vetë «Bashkimit», botime këto më tepër shkollore, që s'uenë as në përdorim të shkollave klerikale për ndonjë kohë të gjatë. Opinioni që u krijua nuk bazohej aq shumë në gjendjen reale, i detyrohej më shumë disa faktorëve të jashtëm, në radhë të parë veprimtarisë e propagandës që kishte zhvilluar kjo shoqëri, lidhjeve të shumta që kishte grupi i anëtarëve dhe përkrahësve të saj, mbështetjeve politike që dështonin etj.⁴⁰

Kërkimet e veçanta dhe studimet që janë bërë pas çlirimit, materialet e të dhënat e reja që kanë dalë, kanë treguar se alfabeti latin i Manastirit nga alfabeti i «Bashkimit» ndryshon pak a shumë po aq sa edhe nga alfabetet e Stambollit e të «Agimit»⁴¹. Alfabeti i Manastirit ka 11 germa të ndryshme nga ai i «Bashkimit» (12 nga i Stambollit, 13 nga i «Agimit»); c/t.s. ç/ch, e/é, ë/e, gj/lgh, nj/lgn, q/c, x/s, xh/zh, d/xh, z/x, zh/xh. Në të tilla kushte del i pakuqteshëm e i çuditshëm pohimi i atyre që e kanë quajtur atë si alfabet të «Bashkimit», me pak ndryshime. Aq më pak qëndron mendimi se alfabeti i Manastirit është alfabeti i «Agimit» me pak ndryshi-

39) Gjergj Qiriazi në relacionin e tij, kur përmend vendimin, flet për alfabet thjesht latin, por kur përligj caktimin e dy alfabeteve (f. 19) flet për alfabet të «Bashkimit»: «Dhe mbasi këto [dy alfabete] qenë përdorur në shkolla, njeri në Gegëri tjetri në Toskëri, ne vendosëm me vota të plota të adaptojmë dy alfabete, atë të Bashkimit dhe atë të Frashërit, me disa ndryshime sipas nevojës së gjuhës».

40) Mbështetje të madhe i dha alfabetit të «Bashkimit» revista «Albania» e Faik Konicës që ishte kundërshtar i rreptë i alfabetit të Stambollit. Alfabeti i kësaj reviste, që ndryshonte nga ai i «Bashkimit» në 10 germa, ju afrua atij nga viti 1900 duke mbetur vetëm katër ndryshime edhe ato në shumicë të pjesshme.

41) Shih I. Zamputi, *Kontribut në historikun e alfabetit shqip*, në «Buletin për Shkencat shoqërore», Instituti i Shkencave, I, 1957, ff. 184-200.

me, ose se ai ka dalë nga të përzjerët e alfabeve të «Bashkimit» e të «Agimit» me disa modifikime ⁴².

Pra në Manastir nuk triumfoi alfabeti i «Bashkimit», as mund të thuhet se fitoi sistemi i tij, se këtë sistem e kishin pasë edhe të tjera botime e autorë ⁴³. Në alfabetin e Manastirit hynë disa digrame ashtu si përdoshin edhe në alfabet të Bashkimit, si *dh*, *th*, *ll*, *rr*, *sh*. Por *dh*, *th*, *rr*, *sh* i kishte përdorur për ca kohë para këtij edhe De Rada, tri prej tyre (*dh*, *th*, *sh*) «Albania» e Brukselit (1896) dhe «Shqipëria» e Bukureshtit (1897).

Po ashtu është vënë në dukje se alfabeti i sotëm nuk ka dalë nga ndonjë kompromis i atypëratyshëm i arritur në Kongres, po ai është kurorëzim i shumë përpjekjeve, që e kanë fillin që nga gjysma e dytë e shekullit XIX ⁴⁴, e sidomos i një pune të vijueshme të bërë në vitet e fundit të shekullit XIX dhe në vitet 1904-8 për ta afruar alfabetin e papërzjerë latin sa të jetë e mundur më shumë me atë të Stambollit, fitore e një rryme që shkonte drejt njëzimit nëpërmjet të afrimit të dy alfabeve më kryesore, rrymë që kishte traditën e saj dhe që kishte arritur në përfundime të rëndësishme (të shprehura në alfabetin e një numër organesh të shtypit kombëtar shqiptar të mërgimit, sidomos të Egjiptit, ku gjejmë variante që s'ndryshojnë veçse në pak germa, ndonjë vetëm në tri, ⁴⁵ nga alfabeti i sotëm), të cilat u bënë mbështetje për punën e Kongresit dhe u shfrytëzuan në vendimet e tij.

Burimet e para të alfabetit të Manastirit duhen kërkuar në shekullin XIX në alfabetet e Dhimitër Kamardës e të Pashko Vasos e, nga fundi i shekullit, të «Albanisë» së Brukselit e të «Shqipërisë» së Bukureshtit, që u përpunuan e u zhvilluan më tej në vitet e para të shekullit XX në mjaft organe të shtypit shqiptar të kohës.

Dhimitër Kamarda qe një ndër ata që i kushtoi më shumë kohë e përpjekje çështjes së alfabetit. Pas orvatjesh së ndryshme, ai arriti nga viti 1869 në përpunimin e dy alfabeve, një me bazë latine, një tjetër me

42) Rev. «Cirka», I, 1963, nr. 13-14, ff. 216-7: «Kur në vjetin 1908 u mblodh në Manastir Kongresi... proponimi [i Mjedës] për alfabet që do t'ishite të përzjerët e atij të Bashkimit me t'Agimit qe pranue një zani me pak ndryshime e asht ai që na përdorim sod». Po ashtu «Cirka», II, 1937, nr. 28-9, f. 202: «Më 1908 [Mjeda] propozoi alfabetin e libravet të vet, që me pak ndryshime u pranue dhe mbeti në përdorim e asht ky i soçmi».

43) Vetë Gjergj Fishta, përfaqësues i «Bashkimit» në Kongres, në një letër të asaj kohe, 5.XII.1908, shkruar një kolegju pohon se të gjithë në Kongres qenë kundër sistemit të «Bashkimit», duhet kuptuar kundër variantit të tij të sistemit të alfabetit thjesht latin: «Impreparati come eravamo al Congresso ed a sostenere la battaglia contro tutta l'Albania-proprio tutti erano contro il sistema Bashkimi — credo che non sia un piccolo successo l'esser riuscito a far adottare il nostro sistema con piena disfatta dell'Agimi» (Gj. Shllaku, *Rreth çështjes së alfabetit të Manastirit*, në «Hylli i Dritës» nr. 4-5, 1943, f. 21).

44) J. Kastrioti, *Ndrrë Mjedja, lavruet i gjuhës shqipe*, në vjetoren «Shkodra» I, nr. 1, 1961, f. 8, ka vënë në dukje afërinë e alfabetit të Manastirit me atë të përdorur nga Pashko Vasa në gramatikën e tij të shqipes botuar në London më 1887, duke ndryshuar vetëm në 6 shkronja.

45) I. Zamputi, *vep. e cit.*, f. 191, 197-8 etj. Aty është vënë në dukje afëria e alfabetit latin të Manastirit me atë të disa organeve shqip të Egjiptit (Kështu alfabeti i gazetës «Besa», 1904, drejtuar nga Thoma Abrami e Milo Duçi, e më pas i gazetës «Pellazgu» 1907, ndryshon vetëm në tri germa *e/é*, *ë/e*, *gj/gh*), po ashtu puna e një rryme të tërë që luftonte për afrimin e alfabetit thjesht latin me atë të Stambollit, dhe çfaqet bindja «se mbi platformën e një rryme të tillë, pati mundësi t'arrihen marrëveshjet në Komisionin e Kongresit të Manastirit».

bazë alfabetin grek ⁴⁶. Me alfabetin e parë ai botoi përmbledhjen poetike të redaktuar prej tij «A Dora d'Istria gli Albanesi», Livorno 1870 ⁴⁷.

Alfabeti latin i Kamardës kishte 25 germa të thjeshta e 16 digrame, për disa variante fonemash përdorte edhe shenja diakritike si *Û, Ë*. Për t'u vënë në dukje është përdorimi i këtyre shenjave me vlerat e sotme: *j, h, z, y, dh, th, gj, nj*. Për *ll, rr, sh* përdoren përkatësisht *ll* e *lh, rh* e *rr sh, sc* e *ç*. Ka *c* me vlerën e *ç*, po ky tingull jepet edhe me *tç*; e përgjithësisht shënohet me *é*, ndërsa e shënon *ë*, në ndonjë rast edhe *e*. Përdoret *ë* për të dhënë një variant të *ë-së* së theksuar. Për *q* ka *kj*, për *c* - *ts*, për *x* - *ds*, për *xh* - *dç*, për *zh* - *zç*. Po të lëmë mënjanë tepërinë e shenjave, përdorimin e disa prej tyre vetëm për disa variante a raste fonemash, nuk ka si të mos bjerë në sy afëria e këtij alfabeti me alfabetet thjesht latinë që u përpunuan e u përdorën më vonë e që shpunë në alfabetin e Manastirit, faktin se alfabeti i Kamardës është burimi kryesor i tyre.

Alfabeti i Pashko Vasës, i botuar më 1877 ka: germa të thjeshta 24, digrama 9 dhe 2 me shenja diakritike. Germat *j, h, q, z, y, z*, digramet *dh, th, gj, nj, sh, xh*, përdoren me vlerat që kanë në alfabetin e sotëm. Ndryshimet me alfabetin qëndrojnë në këto: *lh/ll, rh/rr, e/ë, é/e, c/ç, x/zh, zh/x* e c.

Nga alfabeti i gazetës «Shqipëria» të Bukureshtit, në të cilin shihet një përpjekje për afrim të alfabetit thjesht latin me atë të Stambollit ⁴⁸,

46) Pasqyra të këtyre alfabeleve dha ai në broshurën *Alfabeto Generale albano-Epirotica*, Livorno, 1869. Dh. S. Shuteriqi, *Historia e letërsisë shqipe*, vëllimi II, *Letërsia shqipe e Rilindjes kombëtare*, 1959, f. 42 ka vënë në dukje afërinë e alfabetit latin të Kamardës me atë të Manastirit: «Ishte afërsisht alfabeti që kishte propaganduar Dhimitër Kamarda më 1869 dhe që përdori një mot më vonë në përmbledhjen prej autorësh shqiptarë dhe arbëreshë: a Dora d'Istria, gli Albanesi... , Livorno 1870»; Po ai, *Shkrimet shqipe në vitet 1332-1850*, f. 153, kur bën fjalë për «Il canzoniere albanese» të A. Santorit, 1839, thotë: «Alfabeti i Santorit ka afëri të mëdha me alfabetin e sotëm të shqipes, me germat *dh, ë, j, h, q, sh, th*; ai mund të quhet si një hap i parë drejt këtij alfabeti. Hapin e dytë të rëndësishëm e bëri më 1869 D. Camarda... ».

47) Kjo përmbledhje prihet nga një punim i vogël mbi alfabetin «Della scrittura albanese» (ff. 9-22). Aty, si jepet një vështrim i shkurtër historik mbi shkrimin e shqipes deri në atë moment, mbi alfabetet kryesore të përdorura, parashkrohet gjerësisht sistemi i tij grafik me dy variantet. Kamarda është kundër krijimit të një alfabeti me shkronja të posaçme: «A tutte le nazioni europee, ed in particolare all'albanese certo non fanno bisogno caratteri nuovi, ma si un metodo proprio, e buono per adoperare quelli più ovvii onde sono in possesso da tempo immemorabile (f. 21). Ai mendon se ka arritur t'i japë shqipes një sistem grafik racional e të lehtë: «I quali [gli Albano-Epiroti] accentando il sistema qui dichiarato, con l'uno o l'altro dei due alfabeti abbastanza noti fra loro, a seconda dei paesi ove dimorano, verranno a cessare la deplorabile confusione che regna nel non lieto campo delle lettere albanesi, e ad ottenere si uno strumento idoneo alla cultura del popolo, come il mezzo più facile ed opportuno di corrispondenza e di unione fra le diverse provincie. Ed in ciò si troveranno eziandio in miglior condizione dei Serbi e dei Rumeni: poichè anche questi tengono in uso due alfabeti, il cirilliano ed il latino modificato, ma non regolati dagli stessi principj; e le lettere latine hanno d'uopo di averle espressamente fuse, quali per ogni luogo non si rinvencono. Ora a me sembra che siccome è necessita prima ad un popolo, che voglia crescere nella civile unione, il possedere un metodo uniforme di scrittura, così non meno indispensabile addivenga l'ottenere un siffato metodo per modo che sia altrettanto facile, quanto razionale» (f. 21).

Alfabeti i krijuar nga Kamarda, me gjithë meritat e tij nuk ishte aq i lehtë sa mendonte autori. Kishte përpjekje për të dhënë tepër hollësiara fonetike; më se një herë një fonemë jepej me dy shenja grafike, në ndonjë rast një germë shënohej me tingull të ndryshëm. P.sh. *ü, y = y; ç, tç = ç; ç* edhe *sh; e = e, ë* e patheksuar; *ä, ë, ö = ë* e theksuar.

48) I. Zamputi, *rep. e cit.*, f. 193.

mund të përmendim këto germa me vlerën e sotme; *c, ç, q, e, ë, dh, th, ž, sh*; të ndryshme janë *ī = j, rh = rr, lh = ll, ū = nj, gh = gj, dj = xh, dz = x, j = zh*.

Revista «Albania» e Brukselit (1896), në vitet e para kishte përdorur një alfabet që paraqet mjaft afëri me alfabetin e Manastirit: ai ka *c, q, dh, th, sh*, me vlerat e sotme, ndryshon në *č = c, e = ë, é = e, gh = gj, lh = ll, rh = rr, ū = nj, dz = x, ž = zh, dz' = xh*, duke futur në punë, si shihet, edhe sistemin e digrameve edhe atë të shenjave diakritike.

Këto të dhëna e të dhënat e tjera që janë vënë në dukje në studimet e mëparme japin një ide të udhës që ka përkthyer alfabeti thjesht latin para Kongresit, të burimeve të alfabetit të ri të përpunuar aty, alfabet që u bë më pas alfabeti i vetëm i shqipes. Kështu alfabeti i sotëm është rezultat i një procesi të gjatë që u përfundua në nëndor 1908 me punën e komisionit të Kongresit të Manastirit.

A qe alfabeti i Manastirit vetëm rezultat i një kompromisi pa kritere, a doli ai «nji gja qi pështetej jo aq mbi arësye ditunore, sa dukej ma fort nji vendim i marrun në bazë të nji kompromisi», sikur është thënë prej ndonjë studjuesi të mëparshëm? ⁴⁹. Synimi për të përdorur sa më pak digrame e për t'u afruar me alfabetin e Stambollit, ka sjellë ndonjë inkonsekuencë (si dhënja e grykores qiellzore të tingullit me digramën *gj*, ndërsa e shurdhëta përkatëse s'jepet me *kj* si pritej, po me germë të thjeshtë *q*). Ka vend për të bërë edhe ndonjë vërejtje tjetër. Po s'mund të thuhet me asnjë mënyrë se zgjidhjet, në përgjithësi, nuk janë mbështetur mbi baza shkencore, nuk kanë arësye të mjaftueshme. Bashkëtingëlloret qiellzore, me përjashtim të *q*, janë dhënë, në përshtatje me natyrën e tyre fonetike, me digrame të formuara me shenjën e qiellzores *j* (*gj, nj*), digramet e tjera me germën *h* (*dh, th, sh, zh, xh*), duke ndjekur, për disa, praktikën e mjaft gjuhëve e, për të tjerat, duke e shtrirë e përgjithësuar atë. Janë të paka në anë tjetër inkonsekuencat e digrameve të zgjedhura për alfabetin e shqipes, se s'janë të rëndomta rastet e fjalëve ku takohen tingujt e shënuar prej germave përbërëse të tyre (t-h, d-h, g-j, s-h, z-h), ose s'ndeshen fare në gjuhën letrare (x-h). Bën përjashtim *nj*, po dhe *kjo* ka arësytet e veta. Edhe këto raste mund të gjejnë zgjidhje të përshtatshme në drejtshkrim e të mënjanohet çdo paqartësi.

* * *

Kongresi i Manastirit ka rëndësi jo vetëm për historinë e gjuhës letrare shqipe e për historinë e kulturës shqiptare në përgjithësi, po edhe për historinë politike të Shqipërisë. Vetë çështja e alfabetit, si e thamë, përbënte një problem të mprehtë politik — e këtë e tregoi më së miri lufta që shpërthyer, pas vendimeve të Kongresit, xhonturqit dhe agjentina e tyre kundër alfabetit latin. Përveç kësaj, Kongresi u përpoq të vërë edhe bazat e para për krijimin e një udhëheqjeje organizative unike të lëvizjes kombëtare shqiptare. Në program ishte parashikuar caktimi i klubit që do të bënte punën e klubit qendror, i cili do të bashkërendonte veprimet e klubeve e të shoqërive, do të siguronte lidhjet midis tyre, do t'i përfaqësonte ato në marrëdhënjet me organet qendrore të komitetit xhonturk e të qeverisë osmane. Kjo do të shpinte më vonë në bashkimin e gjithë

49) J. Rrota, *Për historinë e Alfabetit shqip*, 1936, f. 90.

klubeve në një organizatë të vetme në formë federative, me program të përbashkët dhe në krijimin e shtabit qendror udhëheqës të luftës çlirimtare.

Në përshtatje me përbërjen klasore të lkubeve, në Kongres merrnin pjesë njerëz klasash e shtresash të ndryshme, me pikëpamje të ndryshme, përfaqësues interesash e tendencash politike të ndryshme. Rol veçanërisht veprues luanin aty intelektualë borgjezë e mikroborgjezë përparimtarë, po kishte edhe feudalë, klerikë, funksionarë qeveritarë. Ishte e natyrishtme, që rreth caktimit të klubit me të cilin ishte i lidhur në një masë të mirë edhe orientimi i lëvizjes kombëtare, të kishte ndeshje midis grupeve e rrymave të ndryshme. Së fundi dështuan përpjekjet e agjenturës xhonturke për të zgjedhur klubin e Stambollit, po ashtu edhe ato të rrymës oportuniste për klubin e Selanikut të kryesuar prej Midhat Frashërit, që kërkonte ta kufizonte lëvizjen kombëtare në fushën arësimore-kulturore. Disa nga atributet e klubit qendror, pa u njohur shprehimisht si i tillë, iu dhanë klubit «Bashkimi» të Manastirit, ku vepronte një grup i vendosur e plot inisiativë. Edhe kjo përbente një sukses, sado gjysmak, të lëvizjes çlirimtare të popullit tonë — si hap i parë në përforcimin e unitetit politik të tij — dhe të krahut të përparuar të saj.

Në Kongres, s'kuptohet përse, nuk u biseduan çështjet që ishin parashikuar në program lidhur me zhvillimin e arësimit kombëtar, e konkretisht kërkesa për t'ju drejtuar qeverisë osmane për të futur mësimin e shqipes në gjithë shkollat shtetërore turke të Shqipërisë e për të marrë masat për emërimin e mësuesve të nevojshëm, krijimi i shkollave të më të larta shqipe prej vetë shqiptarëve dhe sigurimi i fondeve për mbajtjen e tyre. Këto do të bëheshin objekti kryesor i një kongresi tjetër, i Kongresit të Elbasanit (2-9.IX.1909).

Rëndësi të veçantë ka Kongresi i Manastirit jo vetëm për çështjet që u biseduan në të e për vendimet që u muarën, po edhe për takimet të cilave u dha mundësi të bëhen me rastin e tij, për punën intensive që u zhvillua jashtë mbledhjeve zyrtare të tij. Gjatë ditëve të Kongresit u organizuan edhe takime të veçanta dhe një sërë mbledhjesh të fshehta me njëri-tjetër më të vendosur e më të përparuar në mendime. Në to u shtruan çështje të ndryshme politike, si qëndrimi që duhej të mbanin shqiptarët ndaj xhonturqve dhe fuqive të huaja, kërkesat e tyre më të ngutshme politike, kulturore, ekonomike. Me gjithë demagogjinë mashtruese që kishin përdorur xhonturqit, e mbështetjen që kishin gjetur në elementë të moderuar e oportunistë, kishin filluar të kuptoheshin nga patriotët qëllimet e vërteta të tyre, qëndrimi armiqësor i tyre ndaj lëvizjes kombëtare shqiptare, prandaj u shpreh mosbesimi ndaj sundesve të rinj dhe nevoja për t'iu ndenjur në beh çdo të papriture. Dhe menjëherë pas Kongresit, krahas me zgjerimin e mëtejshëm të veprimtarisë legale duke ngritur klube të reja, duke hapur shkolla të tjera edhe në fshatra, nisën të krijohen në qendra të ndryshme komitete të fshehta për të organizuar e drejtuar më lirisht e më mirë luftën e masave patriotike për të drejtat kombëtare dhe për çlirimin e vendit. Veprimtaria e këtyre komiteteve s'që e pakë, sidomos atëhere kur mundësitë legale të punës, u kufizuan së tepërmi ose edhe u eliminuan fare e kur u desh të rrëmbeheshin armët kundër politikës shtypëse e antishqiptare të xhonturqve për fitimin e autonomisë ose të pavarësisë.

Këto takime e mbledhje shërbyen edhe për përpunimin e platformës politike dhe të programit të lëvizjes sonë kombëtare. U hartua edhe një plan kërkesash politike, ekonomike, kulturore, një kopje e të cilit ju dha deputetit Shahin Kolonja për ta paraqitur në parlament. Në to kër-

kohej të njiheshin zyrtarisht nga qeveria osmane gjuha shqipe e kombësia shqiptare, t'u liheshin më shumë kompetenca organeve lokale të zgjedhura dhe një sërë masash të tjera, që ishin hapa të para drejt autonomisë politike. Çështjet arësimore-kulturore zinin një vend të mirë: shtrohej nevoja që t'i jepej një zhvillim më i madh arësimit, kërkohej që të gjitha shkollat shtetërore turke, fillore e qytetëse, po ashtu edhe ato të komunitetit ortodoks, të ktheheshin në shkolla shqipe, ku gjuha turke të mësohej si gjuhë e dytë vetëm nga viti i katërt e lart; të parashikohej ngritja e një universiteti në Shqipëri e të merreshin menjëherë masa për përgatitjen e kuadrove të duhura; të ngrihej një muze arkeologjik në një qytet të Shqipërisë. Shtroheshin po ashtu kërkesa për zhvillimin ekonomik të vendit; ndërmarrje punimesh botore, ngritje e dy ekonomive të mëdha bujqësore model, ngritje shkollash bujqësore, rregullimi i lumit të Korçës e i liqenit të Maliqit, ndërtim hekurudhash, hapje e shfrytëzim minierash në të mirë të shqiptarëve e jo të huajve. Kërkohej të merreshin masa kundër depërtimit ekonomik e politik të fuqive të huaja, sidomos të fuqive të mëdha imperialiste e të tjera me synime grabitqare ndaj Shqipërisë si Austro-Hungaria, Italia, Greqia, duke promulguar një ligj që të kufizonte veprimin e të huajve në fushën ekonomike, duke shkëputur klerin katolik e ortodoks nga vartësia financiare e politike e huaj.

Si shihet, Kongresi i Manastirit pati një serë përfundimesh pozitive. Ai ndihmoi në përforcimin e bashkimit midis shqiptarëve, në vendosjen e një bashkëpunimi midis tyre në nivelin kombëtar, në kanalizimin e veprimtarisë drejt disa synimesh të përbashkëta. Rezultatet konkrete me të cilat, me gjithë faktorët e ndryshëm negativë e pengesat e ndryshme, i mbylli ai punimet, ishin trimëruese për punën e ardhme dhe shtonin besimin në forcat e mundësitë e popullit shqiptar.

Pas Kongresit, lëvizja kombëtare mori një zhvillim edhe më të madh. Mësimi i shqipes vijoi të ecë përpara, të hyjë edhe në fshat në disa zona. Shqiptarët arritën ta fusim me shumë mundime për një kohë, në disa vende, edhe në shkollat shtetërore turke, fillore, qytetëse, në disa shkolla të mesme, po ende edhe në shkollën e lartë Myliqie të Stambollit. Gazetat shqiptare zunë të shtohen në Shqipëri e në qendra të tjera të Perandorisë osmane.

Përpara një përparimi kaq të shpejtë të idesë kombëtare shqiptare, xhoturqit, të cilët s'kishin veçse nacionalistë borgjezë, që kishin për qëllim vetëm mbajtjen më këmbë të Perandorisë osmane e shpëtimin e saj nga coptimi a shpartalimi, kaluan në një qëndrim armiqësor gjithnjë e më të hapët. Duke lënë mënjanë premtimet e bujshme që kishin bërë, ata, në bazë të politikës së tyre, të mohimit të të drejtave kombëtare të popujve joturq, të programit të forcimit të Perandorisë osmane nëpërmjet osmanizimit të elementeve të ndryshme e heterogjene të saj, të shlyerjes së liriave e të drejtave lokale e të një centralizimi të rreptë administrativ e politik, nisën luftën kundër aspiratave kombëtare dhe lëvizjeve autonomiste e çlirimtare të popujve të shtypur të Turqisë, në radhë të parë të shqiptarëve.

Alfabeti i përbashkët latin vinte në dukje qënjen e kombit shqiptar si komb më vete, përmbi dallimet fetare, theksonte unitetin kombëtar të shqiptarëve dhe mbyllte një rrugë të ndikimit ideologjik e politik të pushtuesit. Për të penguar lëvizjen kombëtare shqiptare, për t'i prerë hovin zhvillimit të vrullshëm kulturor kombëtar, që po shkonte me hapa të shpejta përpara, për të përçarë popullin shqiptar, xhoturqit nxorën që-

shtjen e alfabetit, duke kërkuar të imponojnë në shkrim të shqipes gerrat arabo-turke. Kjo çështje u bë objekt i një ndeshjeje të gjatë, të ashpër ndërmjet masave patriotike shqiptare, të udhëhequra nga klubet e komitetet e fshehta, më njërën anë, dhe xhonturqve, qeverisë osmane, agjentëve të tyre e elementëve fanatikë të manovruar nga ata, më tjetrën anë. Një mbështetje të mirë, një përkrahje të gjithanshme dhe një agjunkturë besnike gjetën xhonturqit të kleri reaksionar mysliman dhe në elementët feudale e të tjerë turkomanë të disa rrethëve.

Agjitacioni për shkonjat arabo-turke, që aty-këtu kishte dhënë ndonjë shenjë, po ende të dobët, edhe në kohë të Kongresit, merr të përhapur menjëherë pas tij. Ndërsa komiteti qëndror xhonturk me hipokrizi shpall zyrtarisht paanësinë e tij, nën rrogos shtyhen elementët fanatikë e reaksionarë të veprojnë kundër klubeve shqiptare, ose të kundërshtojnë të shkruarit e shqipes me gerrat latine. Mbyllen kështu klubi i Shkodrës e më pas ai i Tiranës. Që në janar 1909 qarkullonte një abetare me gerrat arabe. Që atëhere shkruhej në shtyp se «Nga shumë anë të Shqipërisë marrin lajme se turqit e rinj po kundërshtojnë shqiptarët dhe duan t'i ndalojnë të mësojnë gjuhën e tyre. Jemi siguruar për vërtetësinë e këtyre lajmeve». Komitete të ndryshme lokale xhonturke nuk ngurojnë të veprojnë edhe hapët, si në Filat që në shkurt 1909, Tiranë, Durrës etj. Shqiptarët, të grumbulluar rreth organizatave të tyre, mbrojtën me vendosmëri alfabetin kombëtar, arësimin në gjuhën amtare dhe bënë të dështojnë planet xhonturke. Lëvizja kombëtare vijoi të shënojë suksese të reja. Kongresi i Elbasanit (2-9.IX.1909) mirrte vendime me rëndësi për zhvillimin e arësimit kombëtar duke krijuar shoqërinë arësimore «Përparimi», duke themeluar një shkollë normale në Elbasan, dhe caktonte që gjithë klubet të punonin me një program të vetëm.

Lufta u acarua më tepër në vitin 1910. Orvajtjeve të xhonturqve për të inskenuar me anë të agjunkturës së tyre, hoxhallarëve e elementëve të tjerë turkomanë, manifestime në disa vende me kërkesa për alfabetin arab, patriotët shqiptarë ju përgjigjën në shkurt e mars me mitingje masive, si ato të Elbasanit, të Korçës, — ku muarën pjesë 15000 vetë nga gjithë qarku, të Beratit, — ku u dogjën në sheshin e qytetit abetarët me gerrat arabe, të Përmetit e të vendeve të tjera. Masës qeveritare për të mësuar shqipen në shkollat qeveritare me shkronjat arabe, rinia shkollore ju përgjegj me protesta të rrepta, me braktisjen e këtyre shkollave, e në ndonjë vend edhe me akte sabotazhi. Kongresi II i Manastirit (20 mars 1910), protestonte kundër udhës që kishte zënë qeveria osmane, kërkonte që të respektoheshin të drejtat e shqiptarëve, të mos u prekej alfabeti, t'i jepej liri e plotë mësimi të gjuhës amtare, të merreshin masa për zhvillimin arësimor-kulturor dhe ekonomik të Shqipërisë.

Duke i parë të dështuara planet e tyre, xhonturqit kaluan në masa administrative e represive, ndërmuarën operacione, — si operacionin famëkeq të Shefqet Turgut Pashës në pranverë e në verë të vitit 1910, që shpërtheu një reaksion nga më të tërbuarit në Shqipërinë veriore e të mesme, — u përpoqën të mbysin në gjak qëndresën dhe lëvizjen kombëtare shqiptare, duke vranë, prerë, djegur, duke burgosur e internuar patriotët, duke mbyllur e paralizuar klube, shoqëri, shkolla, gazeta shqipe. U bë e qartë për të gjithë se të drejtat kombëtare, qoftë edhe ato të karakterit kulturor, nuk mund të sigurohen veçse me armë në dorë. Kryengritja e vitit 1911 dhe kryengritja e përgjithshme e vitit 1912 shprehën me forcë vendosmërinë e popullit shqiptar për të fituar lirinë, ngritën në një shkallë më të lartë luftën e tij për pavarësi. Mbrojtja e alfabetit dhe e arësimit në gjuhë

amtare vijuan të qëndrojnë si probleme të ditës, dhe të figurojnë ndër kërkesat e para të lëvizjes kombëtare. Këto tri vjet ndeshesh të përgjakshme sollën më në fund ditën e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë në nëndor të 1912.

* * *

Kur përkujtojmë e sjellim në mend këto ngjarje të shënuara të së kaluarës sonë, këto momente të luftës së vështirë të popullit tonë për liri e kulturë, na del vetvetiu para syve udha historike e lavdishme që ka bërë ky popull që prej asaj kohe, na dalin para syve fitoret e mëdha që, i udhëhequr nga Partia e tij e Punës, ka korrur ai me çlirimin njëherë e përgjithmonë nga robëria e huaj e shtypja e brendshme e klasave shfrytëzuese, me vendosjen e pushtetit popullor; na dalin përfundimet madhështore që ka arritur ai në të gjitha fushat në ndërtimin e socializmit në këta vjet jete të lirë.

Këto fitore e kanë ngritur Shqipërinë në një shkallë të tillë lulëzimi, përparimi e fuqie, që jo vetëm s'e kishin përfytyruar, as në ëndërrimet më të guximshme, edhe mendjet më të ndritura të Rilindjes, po që e kanë zili edhe vendet më të zhvilluara.

Shqipëria, më parë vend ekonomikisht ndër më të prapambeturit e Evropës, pa mjete komunikacioni, pa industri, me bujqësi primitive, është kthyer në një shtet me industri moderne, me bujqësi të përparuar.

Vatër e dikurshme e analfabetizmit dhe e padijes, atdheu ynë është bërë sot vend i dritës, i arësimit e i kulturës; pa analfabetë, me një rrjet shumë të dendur shkollash nga më të ndryshmet, të shtrira edhe në skajet më të thella, me një sistem të tërë institucionesh të arësimit të lartë, me institute shkencore kërkimore të ndryshme, me një letërsi të shëndoshë e të fuqishme, me art të lulëzuar. Sot Shqipëria ka operën dhe teatrin e saj kombëtar. Universiteti shtetëror i Tiranës, brenda një kohe të shkurtër, ka arritur të bëhet një qendër e madhe arësimore e shkencore, që ka sot 7 fakultete me 28 specialitete, 45 katedra, 83 laboratore, ku mësojnë më se 8000 studentë dhe zhvillohet një punë e gjerë kërkimore. Në studimet albanologjike nuk zotëron më fjala e shkencëtarit të huaj, po e shkencës së re shqiptare. Zhvillimi i gjuhës shqipe në një gjuhë letrare të përpunuar, të njëzuar e të kritalizuar, me një drejtshkrim të stabilizuar, s'është më një dëshirë mendjesh atdhedashëse e përparimtare, po një realitet.

Procesi i revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës që po zhvillohet me sukses për krijimin e një sistemi të ri arësimesor e të një shkolle të re marksiste-leniniste që t'u përgjigjen plotësisht kërkesave të zhvillimit historik të tanishëm dhe perspektiv, po e ngre arësimin në një etapë të re edhe më të lartë, do ta shpjerë kulturën socialiste shqiptare në suksese të tjera edhe më të mëdha.

Shkëmbi graniti kundër çdo dallge, Shqipëria socialiste, nën udhëheqjen largpamëse të Partisë së Punës, e nderuar dhe e admiruar, ecën sot përpara drejt fitoresh të reja në të gjitha frontet.

R é s u m é

L'ALPHABET ALBANAIS ET LE CONGRÈS DE MONASTIR

(14-22 novembre 1908)*

Le Congrès de Monastir, amplement commémoré cette année dans notre pays, par des conférences, des sessions scientifiques, des études, des articles dans la presse et d'autres activités, comme un événement exprimant un aspect et un moment important de la lutte séculaire du peuple albanais pour la culture nationale, l'indépendance et le progrès, prend place parmi les faits remarquables de la dernière phase de notre Renaissance nationale, d'une portée toute particulière pour la signification qu'il a eue et les résultats atteints.

Ce Congrès est entré dans l'histoire de l'Albanie comme le Congrès de l'Alphabet. Il a pris d'importantes décisions avec, des conséquences durables, en ce qui concerne l'écriture de l'albanais: il a mis un terme à l'état chaotique qui y sévissait, il a préparé l'unification complète de l'alphabet, il a élaboré l'alphabet qui est en usage actuellement. En donnant solution au problème de l'écriture qui en ce moment était un problème politique aigu et non pas uniquement linguistique ou littéraire-culturel, ce Congrès a donné un plus grand élan au mouvement national albanais. Non moins important fut sa directe contribution à la lutte politique libératrice de notre peuple. En établissant des contacts entre Albanais de diverses contrées et tendances politiques, entre bon nombre de dirigeants et militants de la vie culturelle et politique albanaise, il a donné occasion à maintes rencontres et entretiens, ainsi qu'à des réunions particulières secrètes, qui ont contribué à orienter l'activité des organisations albanaises vers des objectifs communs, à coordonner leur action, à cristalliser les revendications nationales albanaises dans les circonstances du moment historique d'alors.

Les décisions du Congrès de Monastir sur l'alphabet furent le couronnement d'une activité prolongée, menée pendant plusieurs siècles pour écrire la langue albanaise, pour améliorer et perfectionner son système graphique; elles furent en particulier la conclusion de maints efforts et de l'activité systématique déployée dans la période de la Renaissance nationale pour doter l'albanais d'un alphabet aussi approprié que possible, exact et unifié, commun à tous les Albanais.

L'alphabet albanais a une histoire longue et complexe, conditionnée par le développement historique de notre pays, étroitement liée non seulement avec son histoire culturelle, mais aussi avec son histoire sociale et politique, étant souvent arène de chocs entre courants, tendances et points de vue divers ou même opposés, où se sont reflétés plus d'une fois orientations et influences culturelles et politiques diverses, des intérêts de classes donnés, et où ont essayé d'agir même des puissances étrangères intéressées. Cette riche histoire est caractérisée par une suite d'efforts à porter la langue parlée au niveau d'une langue élaborée de culture, à raffermir et développer ce chaînon solide de l'instruction en langue maternelle et de la propagation des connaissances parmi le peuple. Elle est marquée par une lutte, souvent difficile, des esprits progressistes et des masses patriotiques et désireuses d'instruction contre les contrariétés et les facteurs négatifs de toute sorte et contre les agissements et visées des ennemis de notre peuple.

*

L'Albanais a été écrit, à ce qu'il résulte de quelque témoignage et d'autres données de voie indirecte, du moins depuis le début du XIV^e siècle**.

Les plus anciens livres imprimés que nous connaissons jusqu'ici sont en alphabet latin. Nos auteurs des XVI^e, XVII^e et XVIII^e siècles ont utilisé les caractères

*) Résumé d'une variante plus développée du rapport lu devant la Session scientifique consacrée au 60^e anniversaire du Congrès de Monastir, tenue à Tirana le 22 novembre 1962.

**) Dans une relation de l'an 1332 du soi-disant moine Brochardus, alias l'archevêque de Tivar, Guillemus Adae, adressée à Philippe de Valois, roi de France (Ch. Kohler, Recueil des historiens des Croisades, Paris, 1909, vol. II, p. 487) il est dit: «licet Albanenses aliam omnino linguam a latina habeant, et diversam, tamen litteram latinam habent in uso et in omnibus suis libris».

latins complétés par quelques caractères spéciaux. Cet alphabet appelé «l'ancien alphabet du Nord», qui s'est maintenu même durant le XIXe siècle et la première décennie du XXe, a été employé en certains milieux, dans quelques sphères de la vie pratique aussi, comme dans les registres de commerce, la correspondance, etc.

A la suite de différents facteurs et conditions historiques, du rôle qu'avaient assumé dans l'Empire Ottoman les langues turque et arabe d'une part, le grec d'autre part, comme langue officielles ou confessionnelles, ainsi qu'à la suite du fait qu'en Albanie n'était permis que le fonctionnement des écoles en langues turque, arabe et grecque, dans l'écriture de l'albanais furent employés, notamment à partir du XVIIIe siècle, aussi les alphabets grec et turco-arabe. Le premier fait son apparition même au début de la domination turque dans une traduction de fragments d'Évangile qui, d'après certains, remonte au XIVe siècle, d'après d'autres appartient à la fin du XVe ou au commencement du XVIe. Ces deux alphabets, notamment le deuxième, n'étaient pas à même de rendre entièrement et d'une façon adéquate le système phonétique de l'albanais.

Pour écrire l'albanais, on a suivi encore une autre voie: celle de forger des alphabets spéciaux. Partant de variantes d'écriture à main d'autres alphabets, notamment grec et slave, leur apportant des modifications en concordance avec les exigences de la langue albanaise, donnant aux lettres un autre aspect, à tel point parfois à faire croire à un alphabet original antique, on a créé au XVIIIe siècle et au début du XIXe un certain nombre de tels alphabets, dont sont parvenus à notre connaissance 4 ou 5. La tentative la plus importante fut celle du maître d'école Théodore Haxhifilipi, dont l'alphabet, vers la fin du XVIIIe siècle et durant le XIXe, fut usité non seulement dans les écrits religieux, mais encore dans des chroniques de famille, des registres de commerce, etc. Vu les circonstances historiques où il apparait, les milieux d'artisans et commerçants de l'Albanie centrale et méridionale où il trouve accueil, ce phénomène assume la signification d'un essai, plus ou moins conscient, d'affirmation de la nationalité albanaise, d'un acte d'émancipation spirituelle, par la mise en relief de l'individualité nationale des Albanais au moyen d'un alphabet particulier.

En somme, jusqu'à la veille de la Renaissance nationale, il y eut plusieurs alphabets, — dont l'emploi, le plus souvent, était limité en des milieux confessionnels, culturels ou régionaux donnés, — l'écriture de l'albanais était caractérisée par le manque d'unité, reflète celui-ci des pénibles conditions sociales et politiques de la vie du peuple albanais, déterminées par le régime féodal et le joug étranger. En ce domaine aussi devant les militants de la Renaissance albanaise se dressait la grande tâche d'unifier l'écriture dans le plan national, de doter l'albanais d'un alphabet approprié et commun à tous les Albanais.

C'est dans cet esprit nouveau que posa et résolut la question de l'alphabet le premier idéologue de la Renaissance albanaise, l'illuministe Naum Veqilharxhi (1797-1858). Considérant qu'il fallait avant tout écrire et cultiver la langue maternelle, propager l'instruction en albanais, donner de l'élan à la littérature albanaise, il créa un alphabet spécial, sans lien avec les alphabets en usage pour être acceptable par tous ses compatriotes, et fit paraître en 1844 et en 1845 un abécédaire. Ce livre dans maints milieux en Albanie et ailleurs trouva un accueil favorable et même enthousiaste, il eut une certaine diffusion dans certaines régions du pays et dans quelques colonies albanaises, mais par suite de bon nombre de facteurs défavorables, notamment de la prompte réaction hostile du Patriarcat de Constantinople et de l'attitude du gouvernement ottoman, ainsi que des difficultés pratiques et techniques que présentait l'écriture et l'impression avec ses caractères, cet alphabet n'atteignit pas le but visé, son emploi resta limité et ne se maintint pas pour longtemps.

De nouvelles tentatives à élaborer un alphabet national furent faites durant les septième et huitième décennies du siècle dernier par un groupe d'Albanais de Constantinople. Pendant des années entières se suivirent des rencontres, des discussions, des réunions de commissions. Le travail fut plus d'une fois interrompu par suite des mesures restrictives du gouvernement ottoman ou des divergences d'opinions, mais autant de fois aussi repris. Ne trouva pas d'appui la proposition de forger un alphabet spécial et on opta pour la base latine. Le travail eut la possibilité d'être mené à terme seulement en 1879 dans la période de la Crise orientale et de la phase culminante du mouvement national albanais qui trouva son expression dans la Ligue de Prizrend. Une commission dirigée par Sami Frashëri, le principal idéologue de la Renaissance albanaise, personnalité connue dans la vie littéraire, scientifique et publicistique de la Turquie sous le nom de Şemseddin Sami, philologue éminent, élaborait un alphabet qui fut approuvé par la Société littéraire albanaise formée en ce temps-là à Constantinople, et rédigea l'abécédaire

respectif. Afin de composer un système graphique exact et simple, on y suivit le critère d'une seule lettre pour un son et d'un son par la même lettre. A la base de ces principes, les caractères simples latins furent complétés par des caractères grecs et par d'autres signes typographiques engendrés par les modifications apportées aux caractères grecs et latins, n'admettant ni les digrammes, ni le système des signes diacritiques.

Les création et le succès de cet alphabet ont marqué une victoire importante de la culture albanaise, de notre mouvement national. Il est devenu le principal albanais de notre Renaissance. C'est en cet alphabet qu'ont été imprimés la plupart de ses publications dans les deux dernières décennies du XXe siècle. Cet alphabet connut une ample diffusion en Albanie, notamment en Albanie méridionale et centrale, mais dans la région de Shkodër, le clergé catholique, avec son particularisme, maintint l'ancien alphabet du Nord.

Basé sur de justes principes scientifiques, cet alphabet, qui prit le nom d'alphabet d'Istanboul, était exact et simple, mais par les caractères hétérogènes dont il se composait, présentait de sérieuses difficultés quant à l'impression, car exigeait des imprimeries très bien dotées ou bien spéciales.

Alors que, vers la fin du siècle, le nombre des imprimés et publications en albanais augmenta et se mirent à paraître des journaux et des revues albanaises partout en Europe, les conditions techniques, mais souvent aussi d'autres raisons, parmi lesquelles les tendances politiques, ont fait usiter de plus en plus aussi un alphabet purement latin, recourant au système des digrammes pour compléter les caractères simples latins, insuffisants à rendre le système phonétique albanais. Quelques uns trouvèrent plus rationnel d'y pourvoir par le système des signes diacritiques, se tenant au critère d'une lettre pour un son.

Dans les premières années du XXe siècle, pour l'écriture de l'albanais étaient ainsi en usage divers alphabets et systèmes, avec des variantes et subvariantes. Pour une partie des sons de l'albanais, l'alphabet assumait des formes diverses, étant employées des caractères divers, des digrammes divers, des combinaisons diverses.

Maintes tentatives sont faites pour rapprocher les alphabets principaux, pour unifier les variantes, mais sans arriver à l'unification complète tant désirée. L'état de choses plus ou moins chaotique, pourrait-on dire, ainsi créé, suscitait de grandes entraves à la diffusion des publications albanaises et de l'instruction en albanais, un développement de la littérature et de la culture albanaise. Tout cela apportait un sérieux préjudice à la lutte de libération, la parole écrite représentant un instrument essentiel de la propagande nationale, un facteur fondamental du réveil national.

A mesure que progressait le mouvement national, étaient de plus en plus ressentis les maux d'un tel état de choses et s'imposait la tâche d'y remédier. A partir des dernières années du XIXe siècle, notamment dans les années 1897-1898, 1905, 1907, etc., dans les pages de la presse albanaise se déroulent d'amples débats à propos de l'alphabet, on discute sur les côtés forts et faibles des systèmes principaux employés, sur leurs avantages et leurs lacunes, on exprime des opinions sur l'alphabet le plus idoine, on fait des propositions sur les voies à suivre pour arriver à une solution du problème. Les opinions étaient partagées notamment entre les partisans de l'alphabet dit d'Istanboul et ceux de l'alphabet purement latin à digrammes, qui se présentait avec diverses variantes, mais qui gagnait de plus en plus de terrain, en raison notamment de sa praticité.

On émit l'idée de résoudre le problème de l'alphabet par une commission de personnes compétentes ou de représentants des organes principaux de presse, ainsi que celle d'y arriver par une réunion plus large et plus représentative de la nation avec la participation des délégués des diverses sociétés et organisations nationales. Il y eut même des initiatives pour la convocation d'un Congrès dans un pays étranger (à Bucarest, Trieste, en Suisse), mais sans aboutir à leur réalisation.

L'effondrement de l'absolutisme tyrannique du sultan Abdül Hamit II et la proclamation de la Constitution (23 juillet 1908) dans l'Empire Ottoman, assenèrent une nouvelle situation, du moins temporairement, pour le mouvement national albanais. Les patriotes s'empressèrent d'en profiter pour faire acquérir au peuple albanais ses droits culturels nationaux, pour s'organiser et donner un puissant essor au réveil national. Sans attendre que les nouveaux gouvernants, les Jeunes-Turcs, aient pris position, ils se mirent à fonder des clubs et des associations, à ouvrir des écoles et des cours d'albanais pour enfants et adultes, à publier des journaux, à entreprendre une vaste action pour la diffusion des idées nationales. Avec les tâches qui se dressaient dans le domaine culturel, la question de l'unification de l'alphabet assumait un caractère d'actualité encore plus criant.

te. Le besoin d'un alphabet unique était partout ressenti, de partout on réclamait l'union, l'unification. En ces circonstances, le club albanais «Bashkimi» de Monastir prit l'initiative de la convocation d'un Congrès national pour résoudre définitivement la question de l'alphabet par l'adoption d'un alphabet unifié et pour s'occuper aussi de certaines autres questions importantes de notre mouvement national de caractère culturel-politique ou politique tout court.

Le Congrès fut convoqué le 14 novembre à Monastir et tint ses assises jusqu'au 22. Y participèrent avec voix délibérative 32 délégués, représentants de 23 clubs, sociétés, villes et communautés albanaises, — publicistes, hommes de lettres, enseignants d'albanais, militants du mouvement politique national et d'autres.

Les séances plénières qui furent publiques et attirèrent une grande affluence d'auditeurs, se transformèrent plus d'une fois en meetings, en manifestations patriotiques ardentes, où fut exprimée avec force le sentiment d'union du peuple albanais et la nécessité de raffermir son unité, l'aspiration de sortir au plus vite du retard séculaire et de marcher à des cadences rapides sur le chemin du progrès culturel et du développement économique, la ferme volonté de jouir des droits nationaux.

Le Congrès désigna de son sein une commission de 11 membres, qu'il munit de pleins pouvoirs à déterminer l'alphabet commun de l'albanais. Dans les séances fermées de la commission se déroula une ardente lutte d'opinions avant d'arriver à trouver une solution admissible pour tous. Se présentaient trois possibilités: a) choisir un des trois principaux alphabets employés, avec ou sans amendements; b) fusionner ces trois, avec les éléments empruntés à eux forger un autre alphabet; c) élaborer un nouvel alphabet, sans prendre en considération les alphabets en usage.

La commission opta au début pour la troisième solution, et résolut de prendre un à un les phonèmes de l'albanais pour déterminer, sur des principes linguistiques justes et en conformité avec la nature de la langue albanaise, leur représentation graphique. Des divergences de vues se manifestèrent notamment à propos des phonèmes pour lesquelles l'alphabet latin n'offrait pas de lettres simples. Enfin, la commission, voyant que le travail traînait en longueur et qu'il y avait des difficultés à arriver à ce moment à une solution unique qui satisfît tous, renonça à son projet initial et décida pour l'emploi de deux alphabets, de l'alphabet dit d'Istanbul partiellement amendé, et d'un alphabet purement latin, élaboré par elle en s'appuyant sur la pratique de la presse albanaise des dernières années, sur les résultats obtenus par le courant du rapprochement de l'alphabet latin pur avec celui d'Istanbul. Les deux alphabets adoptés étaient identiques en leur plus grande partie, ils avaient 29 caractères communs et différaient seulement en 9 caractères.

Les congrès approuva la résolution de la commission et décida l'emploi obligatoire des deux alphabets par les écoles, mais en laissant libre l'usage de l'un ou de l'autre dans diverses publications. Cette solution, dans l'esprit des membres de la commission, était censée valoir pour une brève période transitoire, dont la pratique devrait décider de la vitalité de l'un ou de l'autre alphabet et permettre à passer à la détermination d'un alphabet unique pour l'albanais.

La décision du Congrès de Monastir sur l'alphabet représentait une victoire indéniable du mouvement national albanais. Elle n'aboutissait pas, il est vrai, à l'unification totale, ardemment aspirée, mais la laissait entrevoir et la rendait possible en un assez proche avenir. L'élimination de la possibilité de forger des variantes nouvelles, la mise en usage de deux seuls alphabets au lieu de plusieurs avec des variantes nombreuses, leur rapprochement, représentaient des résultats importants pour l'enseignement de l'albanais, pour le développement de la langue et de la littérature albanaise, une contribution effective au raffermissement de l'unité du peuple albanais.

Les événements historiques qui suivirent, en premier lieu, la lutte acharnée qu'engagèrent les Jeunes-Turcs et le gouvernement ottoman contre l'alphabet albanais en caractères latins et l'enseignement de l'albanais en général, ne permirent pas une reprise de la question. Mais la vie, la pratique quotidienne résolut d'elle-même le problème, sans avoir besoin de décisions de commissions ou de congrès, et cela non longtemps après.

L'alphabet purement latin adopté par le Congrès, qui comptait 9 digrammes et 2 lettres à signes diacritiques, ne s'appuyait pas toujours sur des principes théoriques incontestables, mais il avait le grand avantage d'être homogène en ce qui concerne les caractères, et pratique, c'est pourquoi il prit vite le dessus et devint au bout d'une décennie le seul alphabet employé. C'est l'alphabet actuel de l'albanais.

Le congrès tâcha de prendre des mesures effectives organisationnelles en vue de la constitution d'une direction du mouvement national albanais. Etait incluse dans l'ordre du jour la désignation du club qui devait assumer les fonctions de club central, appelé à coordonner les activités de tous les clubs et associations nationales albanaises, à assurer les liens entre eux, à les représenter dans leurs rapports avec les organismes centraux du Comité jeune-turc et du gouvernement ottoman. Cela visait à aboutir plus tard à une union de tous les clubs en une organisation unique, sous forme fédérative, avec un programme commun. Au bout d'un âpre débat où se heurtèrent les groupements à tendances politiques diverses et parfois opposées, on reconnut les attributs essentiels du club central au club albanais «Bashkimi» de Monastir, où oeuvrait une équipe de patriotes résolus et dynamiques, échouant les tentatives du courant pro-jeune turc et de l'aile réformiste.

En marge des séances officielles du Congrès, eurent lieu une série de contacts et de réunions partielles secrètes où l'on discuta sur la plateforme politique du mouvement national albanais, sur l'attitude à assumer envers les Jeunes-Turcs et les puissances étrangères intéressées, sur les revendications culturelles et politiques albanaises, etc. On y dressa un plan concret de revendications nationales du caractère culturel, économique et politique, englobant la reconnaissance officielle, de la part du gouvernement ottoman, de la langue et de la nationalité albanaise, l'octroi de certains droits d'autonomie administrative, le développement extensif de l'instruction, la conversion de toutes les écoles primaires élémentaires et supérieures du pays en écoles de langue albanaise, l'ouverture d'une université, l'entreprise de travaux publics et de bonification, des mesures effectives contre la pénétration économique et politique et l'intromission dans les affaires albanaises des grandes puissances impérialistes et autres pays intéressés, etc.

Après le Congrès, le mouvement national albanais prit encore un plus grand essor. Mais, aussitôt, les Jeunes-Turcs, lesquels n'étaient préoccupés que d'empêcher l'effondrement de l'Empire Ottoman, passant à l'exécution de leur programme d'ottomanisation des différents peuples qui le composaient et à une politique d'une rigoureuse centralisation, engagèrent une âpre lutte contre les aspirations nationales albanaises.

Afin de contrecarrer le mouvement de libération du peuple albanais, d'entraver l'essor du développement culturel national albanais, ils mirent derechef sur le tapis la question de l'alphabet, cherchant à imposer l'alphabet arabo-turc. Ils ne ménagèrent aucun moyen: agitation, activation de leurs agents, notamment du clergé musulman, actes administratifs, expéditions militaires et mesures represives.

Suivit une lutte acharnée et longue entre les Albanais groupés autour de leurs organisations légales et illégales d'une part et les Jeunes-Turcs et le gouvernement ottoman, d'autre part, lutte qui amena à des rencontres sanglantes et aboutit à l'insurrection générale des Albanais en été 1912, à la veille de la guerre balkanique.